



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Teknik Imazherie dhe Radioterapi”

Universiteti “ALDENT”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Altina XHAFFERI

Dr. Gjok TOSKU

Maj / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në Teknik Imazherie dhe Radioterapi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 441, datë 25.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 150, datë 01.09.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 41, datë 22.04.2022 Ndryshuar me VBA Nr. 12, datë 27.01.2023
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 14 PAE / 14 PAK; 2023-2024 18 PAE / 12 PAK; 2024-2025 21 PAE / 9 PAK;
18	Numri i studentëve:	Va: 2022-2023 58 studentë; Va: 2023-2024 57 studentë; Va: 2024-2025 39 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "ALDENT" (UA) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, me statusin Shkollë e Lartë Universitare. Përgjatë viteve ky IAL ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij. Me VKM Nr. 539, datë 13.06.2013, ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private "Aldent" në Universitet, me emërtimin Universiteti "Aldent". Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 305, datë 24.07.2013, riorganizohet institucioni në 2 Fakultete, në përputhje me Vendimin Nr. 442, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit. IAL ka kaluar disa procese vlerësimi dhe akreditimi të njëjësive kryesore si dhe te akreditimit institucional. Me Urdhër të MAS Nr. 115, datë 13.07.2017 hapet Njesia Kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Me UMAS Nr. 111, datë 11.03.2016 Universiteti Aldent ka kaluar akreditim periodik institucional, në përputhje me Vendimin Nr. 124, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit. Institucioni ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.114, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022. Në vitin 2022 është realizuar procesi i akreditimit të programit të studimit Bachelor në Teknik imazherie dhe Radioterapi. Në vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr 41, datë 22.04.2022 u vendos akreditimi i programit të studimit për studentët e regjistruar ne vitin akademik 2021- 2022. Pas ankimimit nga ana e IAL, Bordi i Akreditimit me antë të Vendimit Nr 12 dt 27.01.203 vendos akreditimin e programit të studimit Bachelor ne Teknik Imazheri dhe Radioterapi me afat vlefshmërie deri më 26.01.2025. Struktura akademike e Universitetit "ALDENT", aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
2. Fakulteti i Shkencave Dentare;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

Programi i studimit Bachelor në "Teknik Imazherie dhe Radioterapi" është hapur me Urdhër të MASR Nr. 441. datë 25.07.2018 me formë studimi me kohë të plotë, 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi ofrohet nga Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJ konstaton që PS Bachelor në "Teknik Imazherie dhe Radioterapi" ka rezultate të prekshme në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke u ngjizur atyre aftësi për të konkretizuar njohuri teknike imazherike në përgjithësi, aftësi për të vetvepruar në kuadrin e organizimit e kryerjes së punëve zbatuese në ambjentet spitalore, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionale, aftësi për të kërkuar zgjidhje duke u konsultuar me përvojën e kolegëve dhe literaturën profesionale, aftësi në menaxhimin e problematikave të ndryshme, njohjen e standarteve dhe metodologjive bashkëkohore. Në të gjitha takimet, por veçanërisht në takimin me studentët, GVJ mësoi që transmetimi i dijeve në kuadrin e këtij PS realizohet me synime të qarta që të diplomuarit e tij të jenë jo vetëm të kërkuar në tregun e punës vendas e të huaj por edhe të realizojnë ambicje të guximshme për të vazhduar studimet e thelluara në ciklet e studimeve Master e Doktoratë. Në përfundim të këtij aktiviteti GVJ konstatoi që PS Bachelor në "Teknik Imazherie dhe



radioterapi” zhvillohet si një program i sukseshëm studimi, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Vetë plani mësimor dhe programet e lëndëve janë profilizuar tashmë në ofertën e dijeve që i çon natyrshëm studentët si tek vazhdimi i cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe tek tregu i punës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). ASCAL, bazuar në *“Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”*, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UA, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Dr. Altina Xhaferi**, dhe **Dr. Gjok Tosku**. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. Grupi u njoh dhe studjoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, plotësimin e informacioneve, konkretizimin e paraqitjeve dhe saktësimin e vlerësimeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me axhendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me datën 4-5 Dhjetor 2024. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Shefin e Departamentit të PS Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”, grupin e vetvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karrierës, sekretarisë mësimore. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”. Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimit të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënien, mësimnxënien dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”, trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë. Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Universiteti “ALDENT”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.04.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 8/4 Prot, datë 28.04.2025. Universiteti “ALDENT”, njofton në ASCAL më datë 05.05.2025, me anë të shkresës me Nr.26/1 Prot, datë 02.05.2025 “Kthim përgjigje për RVJ e programit...”, ku shprehen se konstatimet do të jenë një udhërrëfyes për veprimtarinë në të ardhmen. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 41, datë 22.04.2022 janë:

1. Institucioni, të rekrutojë e angazhojë në këtë program studimi, personel akademik të kualifikuar në fushën e radioterapisë;
2. Institucioni të rrisë numrin e personelit akademik të kualifikuar, për ofrimin e praktikave klinike në këtë program studimi, në fushën e imazherisë dhe radioterapisë;
3. Institucioni, të marrë masa që, fusha e ekspertizës e personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi, të jetë në përputhje me lëndët që ata mbulojnë;
4. Institucioni, të rishikojë emërtimin dhe kurrikulën e këtij programi studimi, duke shmangur ofrimin e dy specialiteteve të ndryshme, si ai i imazherisë e radioterapisë, në strukturën e një programi të vetëm;
5. Institucioni, të shtojë trajnimet profesionale për personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi;
6. Institucioni, të rrisë fondin e literaturës së bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe të huaj, në fushën e imazherisë e radioterapisë;


II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Institucioni ka marrë në konsideratë rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit në vendimin Nr 41 datë 22.04. 2022 dhe perkatesisht sipas pikave:

1. Institucioni ka rekrutuar staf akademik dhe ndihmës akademik të kualifikuar në fushën e radioterapisë. Përveç stafit mjek të angazhuar paraprakisht, evidentohet punësimi edhe i stafit ndihmës akademik me formim Teknik Imazherie, me specializim në radioterapi. (Tabelat RVB Ba ne TIR) GVJ mendon se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.
2. Institucioni ka rritur numrin e stafit akademik (8 persona) me qëllim realizimin dhe ndjekjen në vazhdimësi të praktikave klinike si në radioterapi ashtu edhe në kabinetë apo shërbime të tjera radiologjike. GVJ mendon se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.
3. Institucioni në përgjithësi dhe departamenti në vecanti janë kujdesur që mësimdhënia e stafit akademik të jetë në përputhje me fushën e ekspertizës së personelit akademik të angazhuar. (Tabelat RVB Ba ne TIR) GVJ mendon se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.
4. Programi i ofruar nga Universiteti Aldent përgatit studentë dhe profesionistë të ardhshëm të cilët mund të angazhohen si në fushën diagnostike ashtu edhe terapeutike (radioterapi). Radioterapia mund të konsiderohet një subspecialitet i Imazherisë në përgjithësi ashtu sikurse mamografia, apo mjekësia nukleare. Emërtimi i programit "Teknik Imazherie dhe

Radioterapi" është i përshtatshëm për këtë program i cili thekson që studenti, me formim teknik imazherik, përgatitet me njohuritë bazë si në drejtimin diagnostik. E njëjta filozofi apo parim studimi ndiqet edhe në universitetet dhe programet si motra. *Mbështetur në këtë Universiteti nuk ka ndryshuar emërtimin apo kurrikulën nën këtë arsyetim.*

5. Në procesin e riakreditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofruar ku u evidentua angazhimi institucional për trajnime përfshirje të stafit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ mendon se ky rekomandim është **përbushur plotësisht.**
6. U evidentua rritje e titujve të literaturës për programin Teknik Imazherie dhe Radioterapi, kryesisht në gjuhën angleze. Kjo dhe për shkak të tregut të varfer shqiptar në literaturë në shqip në këtë program. GVJ mendon se ky rekomandim është **përbushur plotësisht.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në : “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Aldent synon mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, përgatitjen e specialistëve të lartë në fushën e mjekësisë, arritjen e standardeve më të larta akademike, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor. Institucioni ofron program studimi që është në përputhje me interesat kombëtare dhe institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë. Referuar statutit, programet e studimit të ofruara nga UA synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UA. Këto programe jo vetëm që tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre. <i>(Statusi i UA)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UA ofron programe në disa prej fushave kryesore shëndetësore duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetit me qëllim ofrimin sa më cilësor të shërbimit ndaj pacientit dhe edukimin e tyre në vazhdim në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. Programi Bsc në Teknik Imazheri dhe Radioterapi ofron një mundësi formimi për studentët në fushën e imazherisë dhe radioterapisë si pjesë e rëndësishme e kujdesit mjekësor. <i>(Statuti i UA)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Referuar RVB-së Universiteti “Aldent” ofron programe studimi që respektojnë gjithë kuadrin ligjor për arsimin e lartë dhe nuk bien ndesh me asnjë interes kombëtar. Studentët në UAL jo vetëm që marrin vlera të shtuara profesionale por edukohen me ndjenjën e humanitetit dhe vlerësimin e interesit kombëtar. Programi i studimit ofrohet në përputhje me interesat kombëtare dhe ato të institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë” si dhe gjetjeve të tij gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Programi i studimit Bachelor në “Teknik Imazhere dhe Radioterapi” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit.

	GVJ i konsultoi paraprakisht dokumentet bazë mbi të cilët zhvillohet aktiviteti i Universitetit "Aldent" dhe konstatoi sipas (nenit 2 të statutit) përcaktohet qartë që programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me rregulloren e Universitetit. Në mënyrë të veçantë programet e studimit të ciklit të parë hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin e Universitetit. Zbatimi i përcaktimeve statutore dhe rregullores së institucionit konstatohet edhe në standartizmin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit si të njësisë kryesore ashtu edhe të njësisë bazë.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UAL ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (hapur me VKM VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit), çka tregon se tashmë se institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Sipas evidencës (Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.2.1), ky Fakultet për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 100 pedagogë, nga të cilët 49 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: - 6 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”; - 14 kanë gradën Doktor Shkencash; - 5 janë në proces për marrjen e gradës Doktor Shkencash; - 24 Asistent Lektorë me Msc; 51 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 1 ka titullin “Profesor”; - 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”; - 16 kanë gradën Doktor Shkencash; - 1 është në proces për marrjen e gradës Doktor Shkencash; - 30 Asistent Lektorë me Msc; Ndërsa Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri ka 16 PAE dhe 19 PAK dhe 1 personel ndihmës akademik. Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik (2023- 2024) sipas evidencës (Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.5.1), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 30 pedagogë gjithsej, ku 18 PAE, nga të cilët: - 1 Prof.Asoc;

	- 5 me gradën Doktor shkencash; - 4 me SPA; - 8 asistente-lektore me Msc; 12 PAK nga të cilët: - 2 me titullin Prof.Asoc; - 3 me gradën Doktor Shkencash; - 3 me SPA; - 4 asistente-lektore me Msc; Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2023-2024 si numër fizik rezulton 60% me 40%. Edhe pse si numër fizik pedagogët efektiv janë në masën 60%, pedagogët efektiv PAE mbulojnë rreth 1000 ore në auditor, e cila perkon me rreth 50% të ngarkesës totale mesimore. (Tabelat RVB Ba në TIR, tabela nr.13.2) Në vlerësimin e të dhënave për vitin akademik 2023-2024 dhe 2024-2025, GVJ mbështetur në dokumentacion dhe në vizitën në IAL konstatoi që Njësia bazë ka kapacitetet, përvojën dhe burimet e nevojshme në fushën akademike për të ofruar programin e studimit.
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	UAL është institucion jo publik në Republikën e Shqipërisë i orientuar tërësisht në ofrimin e programeve të studimit në fushën e mjekësisë. Bazuar në statutin e institucionit, Rregulloren e universitetit, Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të UAL. Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore. Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar. (Statuti i UAL) (Rregullore e Universitetit ALDENT) (Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore teknike) (Rregullore e programit të studimit TIR)
Konkluzione	GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që : - UA ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruajë vlerat akademike kulturore kombëtare; - Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe

	kërkimit shkencor, të formojë specialist të lartë në fushën e mjekësisë; - UA ka kapacitete intelektuale me personel akademik të kualifikuar dhe me përvojë infrastrukturore për të realizuar aktivitetet edukative dhe kërkimore shkencore;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti "ALDENT" ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitet kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitet bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitet kryesore. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. (Statuti i UAL)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe shërbimet mjekësore vendës e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Zyrës së Projekteve e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Konkretisht insitucioni kishte realizuar një trajnim në Turqi për edukimin në vazhdim të stafit akademik dhe studentëve si dhe për krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese për degën e Imazherisë. Referuar dokumentit (Marrevshjet)

	Universiteti Aldent ka nënshkruar një sërë marrëveshje në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion GJV konstatoi që Universiteti Aldent ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit përmes Koordinatorit të Studentëve. Akoma nuk ka përfunduar cikli i parë i studimeve në degën e Teknik Imazherie dhe radioterapi, dhe eksperiencia është akoma e pa konkretizuar por vetë departamenti ishte aktiv në mbështetjen e marrëdhënieve me qendrat spitalore/punëdhënësit përmes marrëveshjeve të ndërsjella dhe organizimeve të përbashkëta. <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Referuar RVB cdo vit akademik, institucioni dhe njësitë bazë kryejnë analizën e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit. UAL dhe partnerët janë përpjekur të harmonizojnë bashkëpunimin e tyre me situatën e re të krijuar. Marrëveshjet e realizuara me institucionet shëndetësore apo akademike kanë impact pozitiv. Vihet re rritje e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program vit pas viti. <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i> <i>(Vizita në sekretari)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit. Rregulloret e Institucionit, njësisë kryesore dhe të organeve të tjera rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave brenda institucionit; - Institucioni realizon marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitalore dhe palë të treta në funksion të realizimit të programit të studimit; - Nëpërmjet marrëveshjeve institucioni është më pranë tregut të punës, kërkesave të tregut të punës dhe do të mundësojë realizimin e praktikave mësimore;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
I				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është i strukturuar në 3 vite akademike, organizuar në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 24 lëndë me modulet përkatëse të ndara sipas 3 viteve shkollorë (8 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë; dhe 8 lëndë në vitin e tretë). Në 24 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihet edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 20, dhe lëndë me zgjedhje janë 4. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i> <i>(Rregullore e programit te studimit TIR)</i>

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi siguron formimin e shprehive të veçanta në fushën e teknikave Radiologjike. Objektivat e programit janë përshtatur me evoluimin e shkencave në imazheri dhe radioterapi. Programi i studimit i aftëson studentët të zhvillojnë kompetenca të imazherisë dhe radioterapisë, etikës profesionale etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i> <i>(Syllabuset Ba ne TIR.)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021 në tabelën nr 1 në Shtojcë janë përcaktuar elementët e programeve të studimit. Për ciklin e parë të studimit, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme dhe duhet të ketë 15 – 20% të krediteve; në kategorinë B, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të kenë 50 – 55% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje dhe duhet të kenë 12 – 15% të krediteve. Ndërsa në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10-15%% të krediteve totale në programet e studimit bachelor. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 3 – 5% të krediteve. Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jenë më pak se 70% në nivelin Bsc. Në planin mësimor të programit të studimit bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” lëndët jepen në kredite dhe të grupuara sipas veprimtarisë formuese në përputhje me legjislacionin në fuqi si vijon:



	▪ kategoria A --- $34/180 = 19\%$; ▪ kategoria B --- $97/180 = 54\%$; ▪ kategoria C --- $23/180 = 13\%$; ▪ kategoria D --- $20/180 = 11\%$; ▪ kategoria E --- $6/180 = 3\%$; Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën në kredite të praktikave klinike si dhe të detyrimeve përmbyllëse. Përkatesisht janë përcaktuar 5 kredite praktike profesionale në vitin e parë akademik, 11.5 kredite praktike ne vitin e dytë akademik (përfshirë këtu dhe praktikat lëndore) dhe 11.5 kredite ne vitin e tretë akademik (përfshirë këtu dhe praktikat lëndore) Në total janë 28 kredite praktika profesionale për këtë program studimi. Ky program studimi ka përcaktuar detyrimet përmbyllëse me 6 kredite për mbrojtjen e diplomës. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR.)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti Aldent është institucion jo publik i cili organizon dhe ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë. <i>(Statusi i IAL, Strategjia e UA)</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të	Referuar RVB-së, si dhe planit mësimor, programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapie ka të njëjtën emërtesë dhe pothuaj përmbajtje të ngjashme të lëndëve në këtë nivel me programe të njëjta të së njëjtës fushë. Hartimi i programit është mbështetur dhe në disa programe të ngjashme europiane. <i>(Raporti i vlerësimit të brendshëm)</i>




ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.				
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Bazuar në udhëzimin nr. 31 dt 15.12.2022, Universiteti ka propozuar kodifikimin në MAS. Në sistemin e brendshëm të sekretarisë ka një kodifikim të programeve të studimit si dhe të lëndëve dhe moduleve përkatëse të këtij programi. <i>(Plani mësimor I PS, vizita në sekretari)</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” ofrohet nga Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri, i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UA. Ky program studimi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se:</i> - Programi i studimit është i organizuara në lëndë e module. Në planin mësimor lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021; - Lëndët në programin e studimit kanë të përcaktuar ngarkesën në kredite ECTS; - Programi i studimit është mbështetur në disa programe të ngjashme europiane;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin

për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”, dhe VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përbëhet nga 3 njësi bazë:

1. Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri;
2. Departamenti I Infermierisë dhe Fizioterapisë;
3. Qendra e Promovimit të Shëndetit;

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, janë të angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, ku për dy vite akademike të dhënat janë si vijon:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike			
	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	1	-	1
Prof. Asoc.	6	3	6	4
Dr./PhD.	14	16	21	21
Msc.	29	31	29	12
Totali	49	51	56	38

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	1	3	1	2	1	3
Dr./PhD.	3	4	4	5	6	5
SPA	6	7	6	5	7	3
Msc.	4	5	5	7	7	2

	<table><tr><th>Totali</th><th>14</th><th>19</th><th>16</th><th>19</th><th>21</th><th>13</th></tr></table> Nga sa më sipër Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Deaprtamenti i Laborantit mjekësor dhe Imazheri përmbushin plotësisht të gjitha detyrimet ligjore që lindin nga ky proces në funksion të arsimit cilësor. <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.2.2)</i>	Totali	14	19	16	19	21	13
Totali	14	19	16	19	21	13		
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri ka angazhuar 1 personel ndihmës akademik por edhe personel teknik radiolog të cilët relizojnë ndjekjen e praktikave profesionale si në laboratorët e IAL ashtu edhe në kabinetet e ndryshme të imazherisë dhe radioterapisë në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit. <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit, Tabela RVB Ba ne TIR, tabela nr 13)</i>							
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka angazhuar një coordinator i cili është përgjegjës për programin e studimit dhe angazhohet në ndërtimin e orarit të çdo semestri, në orientimin e studentëve, bën informimin mbi rregulloren e PS, monitoron procesin mësimor si dhe adreson problematikat e ndryshme që lindin gjatë procesit mësimor. <i>(rregullore e programit të studimit)</i>							
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe caktimin e koordinatorit të programit.</i> <i>Departamenti ka përzgjedhur kordinatoitn e programit të studimit, i cili ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve.</i>							

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri dhe FSHMT zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë. <i>(Plani mësimor, rregullorja e programit; syllabusët e lëndëve; CV e personelit)</i> <i>(Statuti i UAL); (Rregullore e FSHMT); (Rregullore e Burimeve njerëzore)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Referuar planit mësimor të PS, konstatohet se plani mësimor është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018. Programi i studimit "Teknik imazherie dhe radioterapi" është organizuar në tre vite akademike me 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 24 lëndë të ndara sipas 3 viteve shkollorë (8 lëndë në vitin e parë; 8 lëndë në vitin e dytë; 8 lëndë në vitin e tretë). Në 24 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika verore. Lëndë të detyrueshme janë 20. Lëndë me zgjedhje janë 4. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:

	- Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 34 ECTS (19%) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues): 97 ECTS (54%) - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 23 ECTS (13%) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 20 ECTS (11 %) - Kategoria E (detyrimet përmbyllëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3%) Programi i studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. <u>GVJ rekomandon, që për rëndësinë e modulit të Mamografisë kjo duhet të zhvendoset nga Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje) në kategorinë B (lëndë të formimit karakterizues) pasi është modul që duke ditur karakteristikat e profesionit Mamografia duhet të mos konsiderohet lëndë me zgjedhje.</u> <i>(Plani mësimor i Bachelor në Teknik imazherie dhe Radioterapi)</i> <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.12)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit në TIR përmban gjithë informacionet nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit në PS, metodologjinë e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Neni 42 i rregullores së UA, parashikon transferimin dhe ekuivalentimin. UA pranon transferime dhe ekuivalente studimesh nga universitete të tjera në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e unisversitetit. <i>(Rregullore e PS, Rregullore e FSHMT; Rregullore Aldent)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për

secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë: 20 pikë -Aktivizimi (Aktivizimi në orët mësimore, detyrat e kursit, etj.) 80 pikë -- Provimi Përfundimtar; <i>(Plani mësimor i Bachelor në Teknik imazherie dhe Radioterapi)</i> <i>(Syllabuset e lendeve)</i> <i>(Tabelat RVB Ba ne TIR, tabela nr.25)</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Refruar RVB dhe takimeve ne institucion dokumentacioni i programit mësimor është në përditësim të vazhdueshëm dhe në cdo fillim viti akademik dorëzohet sipas formateve të aprovuara dhe të miratura në Senatin akademik dhe arkivohet në department. Programi i studimit ka pasur ndryshime të pakta përgjatë këtyre viteve pasi edhe nuk është mbyllur akoma një cikël i plotë studimi. Megjithë përpjekjet e stafit akademik për përmirësimin e syllabuseve vit pas viti kërkohet punë me kompetencë edhe për përmirësimin e programit studimor. <i>(Programi i studimit)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - <i>plani mësimor është i ndërtuar bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) me ndarjen e kategorive, përshkrimin e detajuar të syllabusit, ndarjen e praktikave dhe të gjithë komponentëve të tjerë;</i> - <i>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kreditet dhe dokumentacionin e pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve;</i> - <i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm;</i>

	- <u>GVJ rekomandon</u>, që për rëndësinë e modulit të Mamografisë kjo duhet të zhvendoset nga Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje) në kategorinë B (lëndë të formimit karakterizues) pasi është modul që duke ditur karakteristikat e profesionit Mamografia duhet të mos konsiderohet lëndë me zgjedhje.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit është i hartuar me lëndë të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e imazherisë dhe radioterapisë. Emërtimi i programit të studimit tregon kompetencat që përfitojnë studentët që diplomohen në këtë program studimi. Emërtimi i lëndëve është në përshtatje me përmbajtjen e tyre dhe janë të njëjta me lëndë të ngjashme që zhvillohen në programe të tjera studimi të ngjashme nga fusha e studimit. Emërtimet e moduleve/lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale mundësojnë njohuri, aftësim për punë të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen kryesisht lëndë bazë të formimit të përgjithshëm ndërsa në dy vitet e tjera akademike programi i studimit parashikon zhvillimin e lëndëve me formim specifik profesional duke ndihmuar kështu në rritjen e kompetencave të studentëve. (Plani mesimor Ba ne TIR)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës.	Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përfitimit të njohurive bazë studenti zhvillon në mënyrë të vazhdueshme lëndë të formimit të thelluar profesional duke përfshirë këtu elementët e studimit që nga Radiologjia konvencionale dhe duke vazhduar drejt lëndëve të cilat merren me radiologjinë e avancuar si CT, MRI, Mjeksësi nukleare. Po ashtu studenti merr njohuri të plota edhe për Lëndën e radioterapisë si element i rëndësishëm i ofrimit të kujdesit shëndetësor. Të gjitha këto

	njohuri i japin studentit aftësinë e nevojshme profesionale për ofrimin e shërbimit të tij në institucionet e ndryshme shëndetësore si dhe në kabinetet e radiologjisë në cdo qendër shëndetësore që i zotëron ato. Nga sa më sipër rezulton se lëndët, shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës dhe aftësimi profesional. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i> <i>(Syllabuset e lendeve)</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. <i>(Programi i studimit BA në teknik imazherie dhe Radioterapi)</i> <i>(Syllabuset e lendeve)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Teknik Imazheri dhe Radioterapi parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme imazherike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një institucion shëndetësor. Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me institucione që ofrojnë shërbime imazherike, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit. <i>(Programi i studimit BA në teknik imazherie dhe Radioterapi)</i> <i>(Marreveshjet e bashkëpunimit për praktikat profesionale)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen	Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit. Literatura në gjuhën shqipe e këtij programi ka problemet e veta në

e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	mungesën e teksteve në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë të huaj. <i>(Syllabuset e lëndeve)</i> <i>(Lista e literaturës në biblioteke)</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Imazheri dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale. <i>(Syllabuset e lëndeve)</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim më të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. <i>(Programi i studimit bachelor)</i> <i>(Syllabuset e lëndeve)</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës;</i> - <i>programi i studimit zhvillohet në tre vite akademike dhe ka një ngarkesë totale kreditesh Europiane prej 180 ECTS. Cdo vit akademik ka 60 kredite ECTS;</i> - <i>GVJ vlerëson se ky program studimi me lëndët në përbërje të tij, mënyra e zhvillimit të programit dhe format e kontrollit të njohurive garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara;</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Departamenti i Laborantit Mjekësor dhe Imazheri, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët shëndetësor dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. <i>(Programi i studimit bachelor)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri. Studentët janë të angazhuar në senat akademik, në NjSBC dhe në disa komisione të tjera në përputhje me aktet ligjore dhe për pasojë janë zë I studentëve dhe pjesë e vendimarrjes. <i>(Takimi ne UA, rregullore e UA)</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar RVB-së si dhe takimeve në Instiucion, Fakulteti i Shkencave mjekësore Teknike mban kontakte me Urdhrin e Infermierit, FSHMT në UMT si dhe disa shoqata europiane me qëllim përditësimin e syllabuseve të disa moduleve si dhe për integrimin e të rejave të fundit në fushën e radiologjisë në përgjithësi. (Marrëveshjet e bashkëpunimit, Raporti vjetor institucional)			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - UA mban ka përfshirje të studentëve në disa komisione në mbështetje të akteve ligjore si dhe bashkëpunon me institucione universitare apo organizata të ndryshme me qëllim përmirësimin dhe integrimin e risive në programin e studimit; - Departamenti ka prioritet përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave në shërbim të njohurive të nevojshme për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Universiteti Aldent përdor forma të ndryshme mësimdhënie që përfshijnë leksionet, seminarët, detyrët e kursit, projektet, laboratorët etj. Vihet re ndërthurje e teorisë me praktikën apo laboratorët në pjesën më të madhe të moduleve dhe lëndëve të këtij programi studimi. Universiteti Aldent në përgjithësi si dhe FSHMT në veçanti ofrojnë infrastukturen e plotë për realizimin e laboratorëve mësimorë, për realkizimin e projekteve në grup të studentëve etj. <i>(Programi I studimit, Vizita e GVJ)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës së GVJ në UA stafi akademik pjesmarrës konfirmoi shumëllojshmërinë e shpërndarjes së informacionit. Leksionet jepeshin tek studentët në forma të ndryshme duke filluar nga paraqitja kompjuterike në klasë, shkarkimi i këtyre materialeve në version elektronik, video etj. Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie duke i alteruar ato në varësi të modulit, temave apo kërkesës së studentëve. Format e metodat e mësimdhënies ju bëhen të ditura studentëve me anë të syllabusve. Në syllabuse pasqyrohen larmia e metodologjisë së përdorur si leksionet me anë të të cilave studentët marrin njohuri teorike të cilat i vënë në praktikë apo krahasojnë praktikat në lidhje me to në orët e diskutimeve dhe detyrave të kursit. <i>(Programi i studimit, Vizita e GVJ)</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Personeli akademik konfirmoi mbështetjen e plotë nga institucioni në përmirësimin e aftësive didaktike të tyre. Institucioni ofron për stafin sistemin elektronik për mësimdhënie, laboratorët apo kabinetet të ngjashme për rritjen e aftësive didaktike të personelit. Gjithashtu UA nxit personelin akademik në përmirësimin e aftësive didaktike me anë të projekteve Erasmus + apo projekte të tjera bashkëpunimi me Universitetet partnerë europiane. <i>(Vizita GVJ, Të dhënat mbi mobilitetin)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie zotëron kualifikimin e duhur akademik për mësimdhënie dhe për kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e këtij programi. Në këtë program, krahasuar me vizitën e fundit në UA, vihet re angazhimi si ndihmes akademik dhe udhëheqës të praktikave profesionale i një numri të shtuar të personave të diplomuar në degën Teknik imazherie si element

dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	komplementar ne mesimdhënien teorike te studenteve te ketij programi studimi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Teknik Imazherie dhe Radioterapi” zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mesimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Njësia kryesore vlerëson format e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme. Studentët shprehën se shumë prej sygjerimeve të tyre janë marrë në konsideratë gjatë procesit të mësimdhënies. Studentët janë aktivë në dhënien e opinionit të tyre jo vetëm nëpërmjet diskutimeve por edhe nëpërmjet pyetsorëve që plotësojnë studentët ku japin vlerësimin dhe mendimin e tyre mbi lëndët dhe format e metodat e mësimdhënies. Njësia kryesore realizon pyetsorë të përvitshëm të fokusuar në metodologjinë e mësimdhënies. <i>(Takimi I GVJ, pyetsori I studentëve)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe	Institucioni realizon leksione të hapura, fton lektorë të huaj, bën trajnime për stafin akademik etj të gjitha këto me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. Lektorët e rinj janë të angazhuar në impelmentimin e metodave inovatore, leksioneve të alternaura me laboratorë apo praktika etj. Gjithashtu UA është mudnuar të përfshijë grup moshë të ndryshme të stafit akademik për të nxitur dhe ndërthurjen e metodave tradicionale me ato innovative të mësimdhënies. <i>(Tabela BA për TIR, RVB)</i>

zbatimit të metodave të reja.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Forma e mësimdhënies në këtë program studimi është ndërthurje formave të mësimdhënies si leksion, diskutime në auditor, detyrë kursi/ese, praktikë profesionale, etj, larmia e metodologjisë së përdorur pasqyrohet në syllabuse;</i> - <i>UA garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se institucioni sanksion mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale në rregullore. Universiteti informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Këto rregullore janë të publikuara eshë në faqen e Internetit të Universitetit. Regullorja e insitucionit parashikon në mënyrë të qartë modalitetet e vlerësimit. Procesi i vlerësimit është një shumatore e vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. UAL ka hartuar dhe miratuar rregulloren e posaçme për mësimdhënien online dhe testimin e njohurive. Komunikimi i rregulloreve nëpërmjet platformës online siguron informimin e plotë të studentëve. <i>(Syllabyset e lendes)</i> <i>(programi i studimit)</i> <i>(Rregullore provimesh)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore	Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, gjatë vizitës në institucion, rezultoi se stafi akademik, në javën e parë të semestrit, informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënit të lëndës, librin shkollor dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e

të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	vlerësimi të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës etj. Syllabuset e lendeve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs. <i>(Syllabuset e Lëndëve të PS)</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet në mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Përgjatë zhvillimit të lëndës bëhen seminare, miniteste projekte, për vlerësimin e njohurive të studentit. Këto janë përshtatur në varësi të strukturës së modulit. <i>(Programi i studimit)</i> <i>(Rregullore e fakulteti)</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia bazë, departamenti dhe personeli akademik përgjegjës për programin e studimit ka prioritet përditësimin dhe përmirësimin e formave të mësimdhënies. UA dhe FSHMT aplikon praktikën e realizimit të pyetsorëve të përvitshëm për stafin dhe studentët me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Po ashtu koordinatori i programit të studimit është në kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe stafin akademik me qëllim reflektimin e problematikave të studentëve në stafin akademik. <i>(Pyetsori I studentëve)</i> <i>(Rregullore e FSHMT)</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe	UA mundëson përdorimin dhe alternimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies në përputhje me rezultatet e pritshme të syllabuseve të ndryshme. Ata nxisin dhe autonominë e studentit nëpërmjet laboratorëve, praktikave apo projekteve të caktuara në grup apo individualisht. Për vetë specifikën e disa moduleve, bashkëpunimi lector – student është më i ngushtë duke oi bërë studentët më konfident dhe më kërkuar. <i>(Syllabuset e lendeve)</i> <i>(Programi I studimit)</i> <i>(Vizita në institucion)</i>

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Për vlerësimin e njohurive përdoren forma të ndryshme kontrolli që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar; - Departamenti dhe personeli akademik përgjegjës për programin e studimit ka prioritet përditësimin dhe përmirësimin e formave të mësimdhënies, në këtë proces një rol të rëndësishëm ka mendimi i studentëve, i cili tërhiqet me anë të anketave, ku pyeten edhe për format dhe metodat e mësimdhënies; - Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të programit të studimit, konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit të studimit, realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar dy periudha kohore të dedikuara për provimet përfundimtare. Provimet e ndërmjetme apo vlerësimi i vazhdueshëm bëhet gjatë semestrit me miniteste, projekte, detyra kursi sipas syllabusit përkatës por në përgjithësi 30% të vlerësimin përfundimtar studenti e grumbullon nga vlerësimi i vazhdueshëm dhe 70% nga provimi përfundimtar. Programi i studimit ka profil të theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit përveç njohurive, bazohet dhe në aftësi të profesionale. <i>(Rregullore e studimit)</i> <i>(Programi i studimit)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme	Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione

elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	provimi me të paktën dy pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimit në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë bërë të ditur studentëve në platformën online. UA ka hartuar edhe platformën e provimeve online, rregullore që i është bërë e qartë edhe studentëve që në fillim të vitit akademik. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit. <i>(Rregullore fakultetit)</i> <i>(Rregullore programi studimi)</i> <i>(Programi i studimit)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar rregullores së programit si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga pedagogu i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj, vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mesimor. <i>(Rregullore programi studimi)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se në fletën e provimit pasqyrohen pikët e grumbulluara si dhe komentet përkatëse për gabimet e bëra. Komentet i përcohen edhe studentit, i cili ka të drejtë ti dijë ato. Në fund të ballafaqimit me studentët pedagogu bën vlerësimin përfundimtar të studentit. <i>(Rregullore programi te studimit)</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti, nëpërmejt rregulloreve të hartuara, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Studenti penalizohet nëse vihen re raste të kopjimit apo të plagjiaturës gjatë realizimit të detyrimeve akademike të tij. <i>(Rregullore fakultetit)</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas	Afatet e përfundimit të vlerësimit janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura edhe në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet në përgjithësi maksimalisht një javë pas periudhës së provimit përfundimtar. <i>(Rregullore e sekretarise)</i>

përcaktimeve në rregulloret përkatëse.				
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentëve u ofrohet e drejta të ankimojnë rezultatet e tyre duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë Departamentit përkatës. Departamenti ngre një komision të posaçëm i cili rivlerëson tezën në prani të studentit dhe pedagogut të lëndës. I gjithë ky process dokumentohet në department. <i>(Rregullore fakultetit)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe realizohet me provim me shkrim dhe me detyra, projekte/ese, raste studimore, etj; - Format e kontrollit të dijes janë të përcaktuara në syllabusin e çdo lënde është i ndërtuar në mënyrë që të jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimet; - institucioni angazhohet në zbatimin e rregulloreve të fakultetit në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të studentëve duke mbështetur fort vlerësimin sipas meritokracisë;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në PS, GVJ është e mendimit se përbërja e planit mësimor si dhe zhvillimi i lëndëve garantojnë mundësinë për thellimin e njohurive, si dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. <i>(Plani mesimor Ba ne TIR)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Referuar planit mësimor 11% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit, dhe ndërveprimit si Informatikë mjekësore, Psikologji, Anglishte profesionale, etj. <i>(plani mësimor) (Programet)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllabuset e lëndëve paraqesin përshkrimin e temave dhe lëndëve, numrin e krediteve, etj dhe me rëndësi të veçantë është përshkrimi i objektivave të lëndës. Çdo lëndë ka objektivat e saj në lidhje me kompetencat që duhet të arrijnë studentët në fund të lëndës së zhvilluar dhe është në lirinë akademike të pedagogëve të zgjedhin metodologjinë dhe format më të mira të arritjes së tyre. Për këtë arsye syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira të studentëve e konkulduar kjo në rezultatin e provimeve, punësimin e studentëve dhe opinionin e vet studentëve në fund të përfundimit të lëndës. Pedagogët në orën e parë të leksionit njohin studentët me syllabusin e lëndës, me objektivat, temat, të drejtat dhe detyrimet, format e vlerësimit, etj, si dhe orientojnë studentët me anë të konsultimeve drejt çështjeve më të rëndësishme si në zhvillimin e provimit të lëndës, ashtu edhe në detyrimet përmbyllëse. Mësimi ka interaktivitet dhe komunikim të rrjedhshëm me studentin gjë e cila shërben dhe për ngritjen e problemeve të ndryshme si dhe orientimin e studentëve për zgjidhjen dhe implementimin e tyre në sferën praktike.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studentët e programit




kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët mjekësore, si dhe në praktikat profesionale. Mbështetur në informacionin e siguruar gjatë takimeve me stafin akademik, studentët, por edhe syllabuseve, stafi akademik inkurajon, nxit dhe mbështet punën në grup të studentëve, për rastet studimore dhe për projektet e kursit. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Teknik Imazherie dhe Radioterapi. <i>(Kurrikula e programit të studimit) (Syllabuset e Lëndëve të PS)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ konstaton nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, se stafi akademik i programit, ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe arritjeve të shkencës. Stafi akademik mbështetet nga Departamenti dhe Universiteti për realizmin e aktiviteteve të ndryshme si leksione të hapura, konferenca, ëorkshope etj.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Programi i studimit ka në përbërje lëndë të rëndësishme dhe bashkëkohore të fushës së imazherisë dhe radioterapisë të cilat mundësojnë pasurimin e studentit me informacione dhe njohuri bazë në këtë fushë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve;</i> - <i>Syllabuset analizohen dhe shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme në funksion të rezultateve sa më të mira që duhet të arrijnë në përfundim të lëndës së zhvilluar;</i>

	- institucioni angazhohet në përmirësimin e metodave të mësimdhënies e cila realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar në DVV si dhe nga informacioni i siguruar nga takimi me studentët, GVI konstaton se institucioni ka një procedurë të posaçme për provimin final, ose mbrojtjen e diplomës, e sanksionuar në rregulloren e institucionit. Institucioni e bën atë publike në faqen e internetit nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht. (Rregullore e Universitetit ALDENT)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Informacioni dhe udhëzimet për provimin final janë vënë në dispozicion të studentëve dhe është e publikuar dhe në faqen online. Pedagogët përgjegjës përgatisin një program mbështetës për provimin përfundimtar. Në raste të caktuara pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët gjatë procesit të përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar. (Syllabuset e lendeve) (Programi i studimit)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të	Provimi i përgjithshëm përfundimtar është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre bachelor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i Departamentit përgatit provimin e përgjithshëm përfundimtar bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.

rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>(Vendim dekani për komisionin e provimeve të diplomimit)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për provimin e diplomimit dhe e shpërndajnë atë tek studentët në fillim të semestrit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato në përgatitjen për provimin përfundimtar. <i>(Rregullore e provimit online)</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët në përgatitjen për provimin përfundimtar. Studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën fizike dhe online për sigurimin e informacioneve të nevojshme për të realizuar kërkimin shkencor si dhe për të kryer analiza krahasuese në varësi të fushës së studimit. Studentët mund të përdorin kompjuterat e laboratorit të institucionit për të kryer studimin.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi përfundimtar dhe projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni përgjegjës për koordinimin e provimin të diplomës. <i>(Rregullore e fakultetit)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje	Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë dhe kompletimin e 180 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomën përkatëse si dhe me Suplementin e Diplomës. <i>(Rregullore e fakultetit)</i> <i>(Formati i suplementit TIR)</i> <i>(Formati i suplementit TIR)</i>

e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.				
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar RVB-së, UAL arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe rast pas rasti bazuar në kërkesat e studentit lëshohen vërtetime me qëllime të ndryshme. Institucioni i ruan ato sipas ligjit për ruajtjen e të dhënave dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Sekretaria lëshon dokumente të ndryshme të miratuara nga institucioni me kërkesë të studentit sipas modeleve të paracaktuara.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - UA ka hartuar rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës; - Studentët orientohen për zhvillimin e provimit të përgjithshëm, dhe tezat e provimit hartohen nga komisioni i caktuar me pyetje të disiplinave Lëndë Karakterizuese; - UA ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të të gjithë studentëve të rregjistruar në të gjithë ciklet e studimit për një kohë të caktuar;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e zhvilluara me stafin, u konstatua se personeli akademik zotëron kualifikimet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë. Personeli akademik është i përzgjedhur në

të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

mënyrë të tillë që të mbulojë fushat përkatëse të programit të studimit, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Ka një ndarje të qartë të përgjegjësiave akademike midis pedagogëve me ekspertizë në fushat specifike si stomatologjia, farmacia dhe shkencat mjekësore. Universiteti Aldent ka në përbërje të stafit akademik pedagogë me përvojë në fushën kërkimore, si dhe profesionistë aktivë në praktikën mjekësore dhe farmaceutike. Kjo ofron një avantazh për studentët, duke siguruar një ndërthurje efektive mes teorisë dhe praktikës. Universiteti ka siguruar një staf teknik të trajnuar për mbështetjen e studentëve në përdorimin e aparaturave dhe pajisjeve laboratorike.

Në këtë program studimi, referuar Tabelës përmbledhëse-Tabelave 5, 5.1 .5.2, të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	1
Prof. Asoc.	1	2	1	2	1	3
Dr./PhD.	4	4	5	3	6	3
SPA	4	5	4	3	6	1
Msc.	5	3	8	4	8	1
Totali	14	14	18	12	21	9

(CV e Personelit Akademik)

(Tabelat Permbledhese Tabelat 5, 5.1 .5.2)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i planeve të ngarkesës akademike për çdo pedagog, u konstatua se personeli akademik efektiv mbulon të gjitha lëndët dhe modulet e programit të studimit në përputhje me kërkesat ligjore. Numri i pedagogëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm është i organizuar në mënyrë të tillë që të sigurohet realizimi i plotë i ngarkesës akademike, duke respektuar standardet e përcaktuara nga ligji për arsimin e lartë. Përveç angazhimit në procesin mësimor, pedagogët janë të përfshirë në veprimtari të tjera akademike, si mbikëqyrja e praktikave profesionale, mentorimi i studentëve dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore. Menaxhimi i këtyre angazhimeve është bërë në mënyrë të tillë që të mos cenohet cilësia e mësimdhënies.

	Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, ndonëse në vitet e mëparshme, mbulimi i ngarkesës nuk ka qënë në raportet 70 / 30, gjatë vitit akademik 2024-2025, ngarkesa mësimore në këtë program studimi mbulohet 82 % (1581 orë) nga stafi akademik efektiv (PAE), dhe 18 % (344 orë) nga stafi akademik me kontratë. Universiteti Aldent ka zbatuar mekanizma për monitorimin dhe rregullimin e ngarkesës mësimore, duke siguruar që pedagogët të mos tejkalojnë limitet e lejuara dhe të ruajnë një ekuilibër të qëndrueshëm midis angazhimeve akademike dhe atyre kërkimore. <i>(Plani Mesimor); (Tabelat Permbledhese)</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Universiteti Aldent ka siguruar një strukturë të qëndrueshme të personelit akademik efektiv për programin e studimit. Përmes politikave të qarta të rekrutimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, institucioni ka garantuar stabilitetin e stafit. Gjatë vlerësimit, u shqyrtuan edhe kontratat e punës midis universitetit dhe stafit akademik. U konstatua se të gjithë pedagogët efektivë kanë kontrata të formalizuara pune, të cilat përcaktojnë qartë detyrimet dhe të drejtat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontratat janë të vlefshme për periudha të përshtatshme kohore, duke garantuar vazhdimësinë e procesit akademik. Institucioni ka siguruar mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për personelin akademik efektiv. Dokumentacioni financiar dhe administrativ dëshmon se të gjithë punonjësit janë të regjistruar në skemat përkatëse të sigurimeve, duke respektuar standardet ligjore për punësimin në arsimin e lartë. <i>(Procedura e rekrutimit të stafit)</i> <i>(Lista e Personelit Akademik)</i> <i>(Tabelat Permbledhese)</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,	Procedura për rekrutimin e stafit përmban të gjitha hallkat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore drejton dhe ndjek të gjithë procesin. Kjo Zyrë është përgjegjëse për fillimin e procesit pasi merr kërkesën nga Njësia bazë. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL. Pasi bëhet shpallja dhe merren në dorëzim dosjet e aplikantëve, ngrihet komisioni përkatës me 5 persona ku të paktën 3 janë anëtarë të Njesisë Bazë i cili shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të miratuar më parë. Kandidatet klasifikohen sipas

strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	pikëve të fituara dhe merret vendimi përkatës. GVJ gjykon që procedura e rekrutimit të stafit garanton rekrutimin e personelit në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e Programit të Studimit. <i>(Procedura e rekrutimit të stafit)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Universiteti Aldent ka angazhuar një numër të mjaftueshëm të personelit ndihmës akademik, i cili përfshin teknikë laboratorësh dhe specialistë të fushave përkatëse. Ky personel është i trajnuar për të asistuar studentët gjatë orëve laboratorike, duke siguruar një zhvillim të qetë dhe efektiv të aktiviteteve praktike. Personeli ndihmës akademik luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe organizimin e pajisjeve, substancave dhe mjeteve të nevojshme për eksperimentet dhe demonstrimet praktike. Vlerësimi në terren konfirmoi se ndihma teknike është në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies praktike. Laboratorët dhe mjediset mësimore të universitetit janë të mirëmbajtura dhe të pajisura me aparataturat e nevojshme. Personeli ndihmës akademik është përgjegjës për sigurimin e funksionalitetit të pajisjeve dhe mirëmbajtjen e rregullt të infrastrukturës. Gjithashtu, ka mekanizma të vendosur për zëvendësimin e pajisjeve të dëmtuara dhe për përditësimin e teknologjisë sipas nevojave të programit të studimit. <i>(Rregullore e burimeve njerëzore)</i> <i>(Labororet e imazherisë)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit	Referuar rregullores së institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se në Universitetin Aldent, mbledhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe ato të personelit ndihmës. Ruajtja dhe përditësimi i këtyre të dhënave realizohet në dosjet përkatëse të personelit. Gjatë shqyrtimit të dosjeve nga GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u vërejt se ato përmbanin të gjitha të dhënat e kërkuara dhe ishin të përditësuara. Po ashtu, gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ shprehu interes për të njohur implementimin e procedurave të rekrutimit të personelit dhe konstatoi se ato ishin realizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	<i>(Rregullore e burimeve njerëzore) (Rregullore e Universitetit ALDENT)</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referuar evidencave të depozituara dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se në Universitetin Aldent, janë zhvilluar marrëveshje dhe bashkëpunime me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi dhe kompani relevante për fushën e studimit, për të siguruar mbështetje të mjaftueshme dhe kualifikim të duhur për personelin e përfshirë në udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale dhe aktiviteteve të tjera të programit të studimit. Angazhimi i personelit për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës dhe punimit të diplomës është i qartë dhe i strukturuar. Gjatë shqyrtimit të informacionit të siguruar nga Zyrat përkatëse dhe dokumenteve të bashkëpunimit, GVJ ka konstatuar se janë të angazhuar individë të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të mbështetur studentët në përmbushjen e kërkesave të praktikës dhe aktiviteteve të tjera. Gjithashtu, GVJ ka shqyrtuar procedurat e rekrutimit të personelit të angazhuar në mbikëqyrjen e studentëve dhe ka vlerësuar se ato janë realizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi. Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet partnere dhe kompanitë e industrisë ka siguruar që praktika profesionale të jetë e lidhur ngushtë me kërkesat e tregut të punës dhe nevojat akademike të studentëve. <i>(Rregullore e praktikave klinike)</i>
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e	Gjatë vizitës në institucion, dhe akteve rregullatore të universitetit, GVJ ka konstatuar se në Universitetin Aldent, personeli mbikëqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, në bazë të marrëveshjeve të arritura me institucionet dhe kompanitë partner, është i angazhuar në mbështetje të studentëve për përmbushjen e detyrimeve të praktikës. Personeli mbikëqyrës ofron udhëzime dhe ndihmë të vazhdueshme për studentët gjatë periudhës së praktikës, duke siguruar që ata të përmbushin standardet e kërkuara dhe të realizojnë detyrimet e caktuara nga programi i studimit. Gjatë procesit të vlerësimit të praktikës profesionale, personeli

vlerësimi të tyre për praktikën profesionale.	mbikëqyrës është i përfshirë në mënyrë aktive, duke kontribuar në vlerësimin e performancës së studentëve dhe ofruar komente dhe sugjerime të dobishme për përmirësimin e punës së tyre. GVJ ka vërejtur se ky proces mbikëqyrjeje është i strukturuar dhe i dokumentuar, me pjesëmarrjen e personelit mbikëqyrës në mbikëqyrjen e studentëve, si dhe në procesin e vlerësimit dhe përgatitjes së raportit përfundimtar të praktikës. Ky angazhim i personelit mbikëqyrës është një faktor kyç për sigurimin e cilësisë së praktikës profesionale dhe përmbushjen e standardeve të kërkuara për përfundimin e suksesshëm të praktikës nga studentët. <i>(Rregullore e praktikave klinike; (Relacion i praktikave klinike)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e duhur të kualifikimit akademik të nevojshëm për përfshirjen në procesin e mësimdhënies në këtë cikël studimi; - institucioni angazhohet në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, të cilat realizohen mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore; - Institucioni ka zhvilluar procedura të qarta për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik dhe atij ndihmës, në përputhje me rregulloret e institucionit; - Në lidhje me praktikën profesionale, institucioni ka siguruar angazhimin e personelit mbikëqyrës të kualifikuar për mbështetje dhe vlerësim të studentëve, duke përfshirë një mbikëqyrje të ngushtë dhe proces vlerësimi të përfundimit të praktikës dhe raportit përfundimtar; - Ndonëse në vitet e mëparshme akademike, mbulimi i ngarkesës mësimore nuk ka qenë në raportet 70/30, gjatë vitit akademik 2024-2025, ngarkesa mësimore në këtë program studimi e tejkalon kriterin 70% të ngarkesës totale;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në RVB dhe evidencat e ngarkuara, si dhe vizitën në institucion, rezultoi se UAL vë në dispozicion ambiente të bollshme dhe shumë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënës duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditoret, laboratorët, dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale. UAL ka në dispozicion një kampus modern me ambiente të dedikuara për një proces akademik me standarte të larta logjistike, me hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, praktike e laboratorike. <i>(RVB)</i> <i>(Labororet e imazherisë)</i> <i>(Planimetria)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, labororë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit që vizitoi GJV u vunë re pajisje të tilla si: tabelat interaktive, projektuesit video, kompjuterat dhe internetin të cilat ishin funksionale. Po ashtu laboratori i anatomisë ishte i pajisur me të gjitha pajisjet dhe instrumentët që nevojiteshin për të realizuar mësimin. Edhe labororët e lëndëve plotësuese si lënda e informatikës apo gjuhëve të huaja ishin të pajisur me të gjitha pajisjet dhe softuerët për zhvillimin e procesit mësimor konform programit të studimit. <i>(RVB)</i> <i>(Labororet e imazherisë)</i> <i>(Planimetria)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 3. Labororët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për	Labororët, në përputhje me natyrën specifike të programit, janë të pajisur me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe objektivat formues të programit të studimit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar vizualizimit të procedurave të ekzaminimit përmes softuerëve demonstrues, duke u mundësuar studentëve praktikimin në modalitetet e marrjes së imazheve dhe kryerjes së ekzaminimeve të ndryshme.



plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratori i imazherisë dixhitale është i përqendruar në zbatimin e metodave inovative në fushën e imazherisë mjekësore. Fakulteti ofron akses në internet përmes Ëi-Fi, ndërsa laboratorit i informatikës është i disponueshëm për studentët edhe për veprimtari të tjera. (RVB)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	(Labororet e imazherisë) (Planimetria) (Vizita në institucion, turi i ambienteve). (Takimi me studentët)			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - institucioni ofron ambiente moderne dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, me hapësira të bollshme dhe të pajisura me teknologji të avancuar; - Labororet dhe auditoret janë funksionale dhe të pajisura me aparaturat dhe softueret e nevojshëm për zhvillimin e mësimin praktik dhe teorik; - Infrastruktura e dedikuara për çdo program studimi mundësojnë një proces akademik me standarte të larta. Kjo siguron një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave të studentëve dhe përmbushjen e kërkesave të programeve të studimit;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimdhënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen	Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit ALDENT. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet

e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	në shërbim të studentëve. Universiteti Aldent gjithashtu ka akses në një numër bibliotekash on-line. <i>(Literatura e programit të studimit)</i> <i>(Librat e blerë së fundmi)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ ka konstatuar se njësia përgjegjëse në Universitetin Aldent siguron përditësimin e literaturës, duke përfshirë botime të fundit, në përputhje me zhvillimet e fushës përkatëse. Literatura e vënë në dispozicion të studentëve përditësohet rregullisht për të reflektuar avancimet më të fundit shkencore dhe profesionale. Ky proces siguron që studentët të kenë akses në materiale moderne dhe relevante që mbështesin përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të kërkuara nga programet e studimit. <i>(Syllabuset e moduleve Viti 1)</i> <i>(Syllabuset e moduleve Viti 2)</i> <i>(Syllabuset e moduleve Viti 3)</i> <i>(Literatura e programit të studimit)</i> <i>(Librat e blerë së fundmi)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve ishin dy biblioteka mësimore me dy salla leximi të pajisura me vende leximi dhe internet. Referuar RVB-së, biblioteka përmban rreth 13500 tituj librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj të klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Në bibliotekën e FSHMT ka rreth 5000 libra në dispozicion. Nuk ka të dhëna mbi efikasitetin e përdorimit të bibliotekës, ndërkohë që literatura bazë-dispencat menaxhohen nga sekretaria mësimore. UAL ka disa vjet që vë në dispozicion edhe bibliotekën on-line "Hinari" bibliotekë e OBSH. Kompjuterat e instaluar në ambientet e bibliotekës ofrojnë akses pa kufizim interneti. Për materialet e bibliotekës ekziston edhe katalogu elektronik. <i>(Literatura e programit të studimit)</i> <i>(Librat e blerë së fundmi)</i> <i>(Takimi me stafin akademik)</i>

Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Ambientet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor. Institucioni i ka krijuar kushte të përshtatshme cdo studenti për aksesimin e bibliotekës si atë fizike ashtu edhe asaj online. Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht. <i>GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekës edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të programit të studimit.</i> <i>(Literatura e programit të studimit)</i> <i>(Librat e blerë së fundmi)</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, takimit me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se Universiteti ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. Studentët kanë akses të plotë në burimet digjitale të literaturës dhe materialeve mbështetëse përmes platformave online të bibliotekës, duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë studentët në përvetësimin e dijeve dhe njohurive të nevojshme. Ky shërbim ofron një mjet të rëndësishëm për mbështetje akademike dhe kërkime shkencore. <i>(Biblioteka dhe menaxhimi i saj)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka e Universitetit Aldent është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike moderne, të cilat mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Biblioteka disponon kompjuterë, softëare të nevojshëm për kërkime akademike dhe mundësi të tjera teknike që mbështesin zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor. Këto pajisje janë të disponueshme për studentët, duke siguruar akses të barabartë dhe pa pengesa për materialet dhe burimet e nevojshme. <i>(Biblioteka dhe menaxhimi i saj)</i> <i>(Planimetria)</i> <i>(Vizita në institucion, turi i ambienteve)</i>

Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka e Universitetit Aldent ofron orare shërbimi të përshtatshme për studentët, të cilat janë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe që ofrojnë mundësi të gjera shfrytëzimi. Ajo është e hapur duke përmbyshur nevojat e studentëve dhe duke u përshtatur me numrin dhe kërkesat e tyre. Ky shërbim fleksibël siguron që studentët të kenë mundësi të plotë aksesimi në burimet bibliografike dhe teknologjike të nevojshme për zhvillimin e studimeve të tyre. <i>(Biblioteka dhe menaxhimi i saj)</i> <i>(Takimi me studentët)</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Referuar rregulloreve të institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se biblioteka e Universitetit Aldent, së bashku me njësitë përgjegjëse të programit, monitoron dhe raporton rregullisht për cilësinë e fondit fizik dhe online të bibliotekës. Ky proces përfshin përditësimin e titujve kryesorë të disponueshëm për programet e studimit, si dhe monitorimin e shkallës së shfrytëzimit të fondit fizik dhe atij online nga studentët dhe personeli akademik. Po ashtu, analiza e përdorimit të sallave të studimit dhe përpjekjet për pasurimin e vazhdueshëm të literaturës, si dhe identifikimi i kërkesave për tituj të rinj, janë pjesë e një procesi të strukturuar për të garantuar cilësinë dhe përmirësimin e shërbimeve bibliotekore. <i>(Biblioteka dhe menaxhimi i saj)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - UA ka krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e bibliotekës dhe burimeve akademike nga studentët, duke siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë në fondet fizike dhe online; - Biblioteka është e pajisur me teknologji moderne dhe ofron orare shërbimi të përshtatshme, duke përmbyshur nevojat e studentëve dhe të personelit akademik;

	- <i>GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekes edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të programit të studimit;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti Aldent disponon sistem të menaxhimit të informacionit me të cilin administron gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre deri në diplomim. Cdo anëtar i stafit dhe cdo student ka adresën e vet të e-mailit, të cilën mund ta aksesojë në cdo kohë brenda dhe jashtë universitetit. Nëpërmjet platformës së edukimit në distancë UAL-LMS, studentët aksesojnë të dhënat personale, rezultatet e provimeve sipas semestrave apo viteve akademike, si dhe të dhëna të tjera didaktike. <i>(Rregullore e sekretarisë)</i> <i>(Platforma e menaxhimit online Fx-Education)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit. Të dhënat e sekretarisë mësimore, stafi akademik dhe studentët koordinohen me anë të platformës Fx Education e cila siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente si për personelin, ashtu edhe për studentët e programit të studimit. Ky sistem integron platformën e edukimit në distancë UAL-LMS, nëpërmjet së cilës pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë në grup ose individualisht, të përcjellin materialet e modulit, të kontrollojnë projektet apo të diskutojnë virtualisht mbi modulën mësimor.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente	


për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ndërsa Programi Fx Education garanton në kohë reale përcjelljen e informacionit të aksesueshëm sipas kategorive në sekretaritë mësimore, përgjegjës programi, titullari, staf akademik dhe studentë. Faqja zyrtare e UAL është aktive në dy gjuhë shqip dhe anglisht, dhe siguron informacion në lidhje me mësimdhënien dhe mbarëvajtjen e procesit studimor në këtë program studimi. <i>(Platforma e menaxhimit online Fx-Education)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Universiteti Aldent ka një sistem të menaxhimit që ka të integruara platforma dhe module të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Ky sistem ofron mundësi për ndarjen e materialeve mësimore, mbështetje të menjëhershme për pyetje dhe diskutime, si dhe monitorimin e përparimit të studentëve në mënyrë të efektshme. Platforma të tilla sigurojnë një komunikim të lehtë dhe efikas, duke përmirësuar procesin mësimor dhe administrativ. <i>(Platforma e menaxhimit online Fx-Education)</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se Universiteti Aldent publikon informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në faqen e tij të internetit, në gjuhën shqipe dhe angleze. Ky informacion është i aksesueshëm për studentët dhe palët e interesuara, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë përdoruesit. Kjo mundëson një komunikim efikas dhe mbështet zhvillimin e një mjedisi akademik të hapur dhe ndërkombëtar.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Institucioni ka krijuar një mjedis efikas dhe të qartë për komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit. Sistemi i menaxhimit mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni të lehtë ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, duke përmirësuar procesin mësimor;

	- Informacionet lidhur me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të disponueshme në faqen e internetit në gjuhën shqipe dhe angleze, duke siguruar akses të barabartë dhe transparencë për të gjithë përdoruesit;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Universiteti Aldent harton një raport financiar të detajuar për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky raport përfshin një analizë të shpenzimeve dhe burimeve financiare të nevojshme për mbështetjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Po ashtu, institucioni ka një plan të strukturuar për mbështetje financiare, duke siguruar që të gjithë resurset e nevojshme për realizimin e programeve të studimit janë të siguruar dhe të menaxhuara në mënyrë efikase. Kjo masë garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve të studimit në afat të gjatë.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase	Në RVB citohet se, që në momentin e planifikimit të hapjes së programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre




apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UAL. Cdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit të UAL. Institucioni kryen cdo vit auditimin edhe pse, duke qënë një institucion jo publik trajtohet si biznes me të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe shtetit. Cdo vit institucioni përpilon pasqyrat financiare:
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	• Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci kontabël); • Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve); • Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare; • Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Nga raportet financiare të UAL dëshmohej se, institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve Rritja ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UAL. <i>(Strategjia e UAL)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Universiteti Aldent ka një sistem të mirëstrukturuar financiar që mbështet programet e studimit dhe siguron kushte të përshtatshme infrastrukturore dhe akademike; - Planifikimi i detajuar i kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare siguron realizimin e procesit mësimor dhe përmbushjen e nevojave të programeve të studimit për një cikël të plotë;

	- Pasqyrat financiare dhe auditimet vjetore dëshmojnë një gjendje të qëndrueshme financiare dhe rritje të vazhdueshme ekonomike, e cila ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe infrastrukturës të universitetit;		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni siguron, përmes statutit të Universitetit "Aldent" dhe rregulloreve të tij, zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto përfshijnë zbatimin e ligjit në Rregulloren e FSHMT-së, Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit. Rregullorja e programit përcakton procedurat e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, si dhe procesin e diplomimit, duke hartuar politika që sigurojnë barazinë mes studentëve. Universiteti Aldent harton dhe zbaton politika dhe procedura të plota që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga hyrja deri në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tij rregullatore. Këto politika përfshijnë procedurat e pranimit, zhvillimit të studimeve, mbështetjes akademike, si dhe diplomimit, duke siguruar që të gjithë studentët të trajtohen në përputhje me standardet ligjore dhe akademike. Ky sistem garanton transparencën dhe ndihmon në mbështetje të zhvillimit të një procesi akademik efikas dhe të rregullt. (Statuti i UAL) (Rregullore e UAL)

	<i>(Rregullore e Fakultetit FSHMT)</i> <i>(Rregullore e Departamentit Laborant mjekësor dhe Imazheri)</i> <i>(Rregullore e programit të studimit Ba në Teknik imazherie dhe radioterapi)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriteret e percaktuara nga MASR për pranimin në ciklin e parë të studimit respektuar renditjen sipas pikëzimit. <i>(Rregullore e programit të studimit Ba në Teknik imazherie dhe radioterapi)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Universiteti Aldent harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të qarta dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programet e studimeve. Këto kriteret janë në përputhje me ligjin dhe udhëzimet përkatëse dhe parashikojnë gjithashtu regjistrimin e studentëve të huaj. Institucioni bashkëpunon ngushtë me strukturat e ngritura për zbatimin e maturës shtetërore, duke siguruar që procesi i pranimit të jetë i drejtpërdrejtë, transparent dhe i rregullt. Sekretaria mësimore mban regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretaria firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretari, përkatësisht dosjeve të studenteve, GVJ evidentoi që ato ishin të plota dhe konform rregulloreve në fuqi. Kushtet dhe procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve bëhen me dije nga koordinatori i programit. Ndërsa kriteret dhe procedurat e përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përgjegjësi e pedagogëve dhe lehtësohen e mbështeten nga tutori i grupit. <i>(Rregullore e programit të studimit Ba në Teknik imazherie dhe radioterapi)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së	Universiteti Aldent ka përcaktuar dhe publikuar kriteret dhe procedura të qarta për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve, përparimin e tyre gjatë kursit të studimit, transferimin e krediteve, njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, vlerësimin e dijeve dhe procesin e diplomimit. Këto procedura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për

studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	publikun, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për studentët dhe të interesuarit. (Rregullore e programit të studimit) (Procedura e transferimit)
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Universiteti Aldent, përpara fillimit të çdo viti akademik, informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimit. Kjo informim është i detajuar dhe i aksesueshëm për të gjithë, duke siguruar që kandidatët dhe studentët e mundshëm të kenë njohuri të plota rreth kushteve dhe kërkesave të programeve përkatëse. Ky proces mundëson një pranimin dhe planifikim të qartë dhe të bazuar në informata të sakta për të gjithë palët e interesuara. (Rregullore e programit të studimit)
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Universiteti Aldent harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret të qarta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kriteret janë të aksesueshme dhe janë të dizajnuara për të siguruar mundësi të barabarta pranimi për të gjithë kandidatët, pa diskriminim, duke mbështetur përfshirjen e këtyre grupeve në procesin e arsimit të lartë. Gjithashtu, para çdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambienteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim. Para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambienteve të Universitetit stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep gjithë informacionin e nevojshëm për pranim. (Statuti i UAL) (Rregullore e UAL) (Rregullore e programit të studimit) (Takimi me dekanin, studentët) (RVB)
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	Universiteti Aldent harton dhe publikon përpara fillimit të çdo viti akademik kriteret të qarta për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Këto kriteret janë të aksesueshme dhe

kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	ofrojnë informacion të detajuar për të mundësuar procesin e pranimit të studentëve ndërkombëtarë. Ky veprim siguron që kandidatët nga shtete të tjera të kenë mundësi të barabarta për t'u pranuar në programet e studimit, duke ndihmuar në promovimin e diversitetit dhe ndërkombëtarizimit të institucioni. <i>(Rregullore e programit të studimit)</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga vizita në Institucion dhe takimet e zhvilluara, GVJ konstatoi se Universiteti harton politika bursash për shtresa në nevojë, si dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me prioritet për institucionin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Këto politika janë të dizajnuara për të siguruar mundësi të barabarta për kandidatët e paavantazhuar dhe për të kontribuar në forcimin e kapaciteteve akademike dhe profesionale të studentëve, si dhe për të mbështetur zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ky angazhim përfshin një qasje gjithëpërfshirëse dhe të drejtpërdrejtë për arsimimin e grupeve të ndryshme.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Universiteti Aldent ka një sistem të mirëstrukturuar dhe të qartë për pranimin e studentëve, duke përfshirë politikë dhe kritere të përcaktuara për kategoritë e ndryshme të kandidatëve, përfshirë ata me aftësi të veçanta, nga shtete të tjera, dhe ato nga shtresat në nevojë;</i> - <i>Institucioni publikon dhe komunikon me transparencë kriteret dhe procedurat përpara çdo viti akademik, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë studentët potencialë;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të	GVJ konstaton se, njohjen me rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës e

hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	kryen përgjegjësi i programit i cili e ka detyrim institucional. Universiteti Aldent vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është i aksesueshëm për studentët dhe të interesuarit, duke siguruar që ata të kenë njohuri të plota rreth kushteve dhe procedurave të përparimit, vlerësimit të rezultateve dhe kalimit në vitet e ardhshme. Kjo mundëson një proces transparent dhe të drejtë për të gjithë studentët. <i>(Rregullore e programit të studimit)(RVB)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Referuar RVB-së kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve përcaktohen në Rregulloren e UA dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati prej studimeve të mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani i Fakultetit. Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulin, ditën e parë të mësimit. <i>(Syllabuset)</i> <i>(Rregullore e UAL)</i> <i>(Rregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Informimi në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të përcaktuara në rregulloren e Programit të studimit. Gjithashtu, në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulin, ditën e parë të mësimit. <i>(Rregullore e programit të studimit) (Syllabuset)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Referuar rregullores së institucionit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se Universiteti Aldent informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Në fillim të ciklit të studimeve, Përgjegjësi i programit informon studentët mbi procedurën e diplomimit, duke lënë kohë për zgjedhjen e fushës dhe në fillim të vitit të dytë, duke u këshilluar me pedagogët, studentët plotësojnë formularin përkatës. <i>(Formati i diplomes, Suplementi i diplomës)</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Cdo fillim viti, studentëve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjigjësit të programit. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese. Po ashtu, institucioni organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, mundësitë e ofruara dhe kërkesat e nevojshme për regjistrim. Ky proces informimi i detajuar dhe transparent ndihmon studentët të bëjnë zgjedhje të informuara dhe përgatiten për programet e studimit në institucion.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Universiteti Aldent ka një proces të qartë dhe të hapur për informimin e studentëve dhe të interesuarve në lidhje me kriteret dhe procedurat e ndryshme akademike;</i> - <i>Institucioni siguron transparencë të plotë për kriteret e përparimit akademik, vlerësimit, punimit të diplomës dhe diplomimit, duke ofruar udhëzues të detajuar dhe organizuar takime informuese për studentët e ardhshëm;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se studentët janë të informuar në detaje për strukturën dhe organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si dhe periudhat e provimeve, përmes kalendarit akademik të ofruar nga Përgjegjësi i programit. Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u ofrohet katalogu i shkollës, si dhe tabela informuese në auditoret e leksioneve. Kjo siguron që ata të kenë një kuptim të plotë për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe aktivitetet formuese. <i>(Takimi me studentet)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të	Institucioni siguron informacion të plotë dhe të aksesueshëm për studentët lidhur me lëndët dhe modulet përmes udhëzuesve

studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	të detajuar që përfshijnë objektivat, përmbajtjen, metodat e vlerësimit dhe aktivitetet formuese. Ky informacion është i disponueshëm në katalogët akademikë, materialet online në platforma si UAL-LMS dhe Fx Education, si dhe nëpërmjet shpërndarjes fizike në auditorë. Për çdo lëndë, studentët kanë akses në oraret, kalendarët dhe udhëzuesit që përmbajnë detajet e aktiviteteve mësimore dhe praktikat, duke i mundësuar atyre një përgatitje të plotë dhe të përditësuar për programin e studimeve. <i>(Takimi me studentet)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ofron informacion të plotë për mundësitë e punësimit dhe siguron mbështetje të vazhdueshme për orientimin e studentëve drejt tregut të punës përmes Zyrës së Karrierës, e ngritur specifikisht për këtë qëllim. Kjo zyrë është e angazhuar në zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe profesionale, duke mbajtur kontakte të rregullta me studentët dhe të diplomuarit për të ndjekur dhe mbështetur zhvillimin e karrierës së tyre. Ajo ofron mbështetje për krijimin e dokumentacionit të nevojshëm, siç janë CV-të dhe letra motivimi, për të përgatitur studentët për mundësitë e punësimit në tregun e punës. Nëpërmjet Zyrës së Karrierës, studentët informohen dhe përditësohen mbi mundësitë e praktikave profesionale, mundësitë për punësim dhe mundësitë për zhvillim profesional, të cilat janë të disponueshme përmes orareve mësimore, aktiviteteve të praktikave dhe mundësive të tjera që lidhen me tregun e punës. Zyra gjithashtu ndërmjetëson kontaktet midis studentëve dhe mundësive të punës dhe përfundon procesin e lidhjes me punëdhënësit për studentët që janë të gatshëm të fillojnë karrierën e tyre profesionale. Faqja zyrtare e Universitetit Aldent ofron mundësinë për studentët të përdorin rubrikën "portal i studentit" për të aksesuar informacionet e nevojshme për procesin mësimor dhe mundësitë profesionale që ofrohen, duke siguruar një mbështetje të plotë dhe të aksesueshme nga çdo pajisje elektronike që është lidhur me internetin. Kjo qasje e strukturuar dhe e koordinuar siguron që studentët të kenë mundësi të plota dhe të përditësuara për orientimin drejt karrierës, si dhe mbështetje të vazhdueshme për të hyrë në tregun e punës. <i>(Raport vjetor I UAL)</i> <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>

	<i>(Relacion i praktikave klinike)</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni ofron informacion të përditësuar dhe të detajuar për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë oraret e ligjëratave, praktikat dhe aktivitete të tjera akademike. Ky informacion është i disponueshëm përmes platformave online, si UAL-LMS, dhe është gjithashtu i shpërndarë nëpërmjet tabelave informuese në auditorë dhe zyra. Po ashtu, studenti ka akses në informacion për logjistikën e procesit mësimor, siç janë ndarjet e auditorëve, disponueshmëria e materialeve dhe shërbimet mbështetëse. Infrastrukturat, si bibliotekat, labororet dhe pajisjet teknologjike, janë gjithashtu të dokumentuara dhe të aksesueshme për studentët, duke siguruar kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor. Shërbimet mbështetëse, si asistenca teknike dhe mbështetja për studentët, janë gjithashtu të informuara dhe të lehtësisht të aksesueshme. <i>(Biblioteka dhe menaxhimi i saj)</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni siguron që informacioni i lidhur me programin e studimit, përfshirë përmbajtjen e lëndëve, oraret, praktikat, dhe informacionin për vlerësimin, të jetë i disponueshëm përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky sistem, siç është UAL-LMS, lejon studentët të kenë akses në informacionin e nevojshëm në çdo kohë dhe nga çdo vend, duke mundësuar një mësim dhe menaxhim të përshtatshëm të studimeve, edhe në distancë. Platforma ofron një ndërfaqe të thjeshtë dhe të qartë për t'u përdorur, duke siguruar që studentët të mund të aksesojnë materialet mësimore, të ndjekin njoftimet e rëndësishme dhe të menaxhojnë detyrat e tyre akademike pa pengesa. <i>(Platforma e menaxhimit online Fx-Education)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Universiteti Aldent ka një sistem të strukturuar dhe efikas për informimin e studentëve mbi mundësitë e ofrura gjatë procesit mësimor dhe mbështetje të vazhdueshme për orientimin drejt tregut të punës; - Institucioni siguron informacion të plotë dhe të përditësuar për lëndët, modulet, aktivitetet formuese dhe mundësitë e zhvillimit profesional, duke ofruar udhëzues të detajuar dhe platforma online të aksesueshme për studentët, si UAL-LMS dhe Fx Education;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni siguron mbajtjen dhe përditësimin e statistikave vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në çdo program studimi. Këto të dhëna përfshijnë informacion të detajuar mbi pranimin e studentëve, arritjen e përfundimit të studimeve dhe normat e diplomimit. Statistikat janë të organizuara dhe të aksesueshme për analizë të brendshme dhe janë të ofruara në mënyrë transparente për palët e interesuara. Përmes këtyre të dhënave, institucioni monitoron dhe vlerëson suksesin e programeve akademike dhe i siguron autoriteteve përkatëse informacion të rëndësishëm për planifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave akademike. <i>(Rregullore e sekretarise)</i>															
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore, statistikën vjetore me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit për cdo program studimi. Universiteti, disponon dokumentacionin vjetor me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ngrirjen e studimeve, largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Informacioni ruhet në kohë reale dhe menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore, nëpërmjet Fx Education. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education. Nga dokumentacioni i administruar dhe vizita në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr i të regjistruarve</th><th>Nr i të cregjistruarve</th><th>Nr Aktual</th><th>Nr i të diplomuarve</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>60</td><td>2</td><td>58</td><td>39</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>59</td><td>2</td><td>57</td><td>58</td></tr></table>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr Aktual	Nr i të diplomuarve	2022-2023	60	2	58	39	2023-2024	59	2	57	58
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr Aktual	Nr i të diplomuarve												
2022-2023	60	2	58	39												
2023-2024	59	2	57	58												

	2024-2025	39	-	39	-
	<i>(Manual perdorimi Fx)</i>				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, informacioni mund të futet dhe modifikohet vetëm nga persona të autorizuar, në përputhje me detyrën e tyre (sekretaria, dega mësimore, tutori akademik), ndërsa mundësia për të aksesuar të dhënat pa të drejtë manipulimi është e rezervuar për një grup të caktuar personash të autorizuar. Referuar RVB-së, institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Ky raport përfshin një analizë të cilësisë së studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjeron masa të mundshme për përmirësimin e cilësisë. <i>(Rregullore e sekretarise)(Raport vjetor I UAL)</i>				
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni siguron një proces të rregullt dhe të përvitshëm kontrolli dhe monitorimi pranë të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin, si sekretaritë mësimore dhe sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky kontroll periodik ka për qëllim vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike. Përmes këtij procesi, institucionet sigurojnë saktësinë dhe përditësimin e të dhënave, si dhe garantimin e cilësisë së informacionit dhe dokumenteve që përdoren për menaxhimin e proceseve akademike. <i>(Rregullore e sekretarise)</i> <i>(Raport vjetor I UAL)</i>				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Njësia bazë është e angazhuar në hartimin e raporteve analitike dhe periodike që vlerësojnë profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, duke analizuar gjithashtu shkallën e suksesit të punësimit pas diplomimit. Ky proces përfshin mbledhjen e të dhënave për suksesin akademik të studentëve dhe për realizimin e mundësive të punësimit, duke e shoqëruar këtë analizë me masa konkrete për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të programeve akademike dhe shërbimeve mbështetëse. Raportet ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aspektet që mund të				

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	përmirësohen dhe mundësitë për rritjen e suksesit të studentëve dhe diplomuarve në tregun e punës. <i>(Raport vjetor I UAL)</i> <i>(Rregullore e tutoriatit akademik)</i> <i>(Tabelat përmbledhëse)</i> <i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - institucioni ka një sistem të mirëorganizuar dhe efikas për mbledhjen, menaxhimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike; - Nëpërmjet kontrollit periodik dhe raporteve analitike, ai siguron që të dhënat për profilin e studentëve, cilësinë e punësimit dhe rezultatet akademike janë të sakta dhe të disponueshme për analizë; - Institucioni gjithashtu përdor një qasje të qartë dhe transparente për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e programeve, duke mbështetur zhvillimin e studentëve dhe orientimin e tyre në tregun e punës;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti dhe rregullorja e Universitetit Aldent parashikojnë përfshirjen e studentëve në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë." Studentët organizohen në Senatin Studentor, me një senator për çdo grup mësimor, dhe janë të përfshirë gjithashtu në komisione të tjera, ku ata janë përfaqësues, si në NJSBC, komisionin e kurrikulave, GVB, dhe komisionin e kërkimit shkencor. <i>(Statuti i UAL) (Rregullore e UAL)</i>

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ vëren se Universiteti Aldent ka një sistem të qartë dhe funksional për përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrjen dhe këshillimin mbi procesin akademik. Përfshirja e studentëve është reale dhe konkrete, duke u mundësuar atyre të jenë pjesë aktive e Senatit Studentor dhe të komisioneve të ndryshme si NJSBC, komisioni i kurrikulave, GVB dhe komisioni i kërkimit shkencor. Ky proces i përfshirjes ofron mundësi të barabarta për studentët të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë akademike. Gjithashtu, rezultatet e këtij angazhimi janë të matshme dhe lehtësisht të verifikueshme, përmes analizës së ndryshimeve dhe përmirësimeve që janë implementuar si pasojë e kontributit të studentëve në vendimmarrje. <i>(Statuti i UAL)</i> <i>(Rregullore e UAL)</i> <i>(Takimi me stafin, Takimi me studentët)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Universiteti Aldent siguron një përfshirje aktive dhe të rregullt të studentëve në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Njësitë përgjegjëse organizojnë mbledhje të përbashkëta në departament, ku studentët mund të kontribuojnë me mendimet dhe sugjerimet e tyre për programet akademike. Për më tepër, përdoren metoda të ndryshme si pyetësorët, grupet e fokusimit dhe sondazhet për të siguruar që studentët të kenë mundësi të shprehin mendimet e tyre. Sugjerimet dhe kontributet e studentëve reflektohen në ndryshimet dhe përmirësimet e programeve të studimit, duke garantuar që ato të përmbushin nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, si dhe të përmirësojnë cilësinë e procesit mësimor. <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Takimi me stafin, Takimi me studentët)</i> <i>Rregullore e Këshillit studentor</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentet rregullatorë. Të drejtat e studentëve respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, të komentojnë ato dhe të ndjekin të gjitha hapat e ankimit për rivlerësim. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, u vërejt se atmosfera në institucion është shumë pozitive. Filozofia e institucionit është që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije gjatë periudhës së studimeve të tyre.

njesisë/pedagogut përgjegjës.	(Rregullore e NjSBC) (Takimi me stafin, Takimi me studentët)			
Konkluzione	GVJ kontstaon se: - Institucioni ka krijuar një sistem ku studentët janë të përfshirë aktivisht në proceset vendimmarrëse dhe përmirësuese të programeve akademike, duke siguruar mundësi për të kontribuar në mënyrë konkrete dhe frutdhënëse; - Studentët kanë të drejtën e ankimit për shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin në provim;			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi informacione më të detajuara në lidhje me procedurat dhe njësitë përgjegjëse për informimin e studentëve dhe shërbimet e ofruara për ta, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të universiteteve. Në përgjigje të këtij kërkimi, Përgjegjësi i Departamentit na ofroi një informacion të detajuar mbi kërkesën tonë. Sipas tij, informacionet bazë për studentët janë të disponueshme në faqen zyrtare të institucionit, e cila përditësohet rregullisht. Po ashtu, zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë vazhdimisht studentët dhe ofrojnë shërbimet e kërkuara prej tyre. (Takimi me stafin, Takimi me studentët)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë	GVJ vëren se Universiteti Aldent ka implementuar një sistem të strukturuar dhe funksional për mbështetje të studentëve gjatë gjithë procesit akademik. Ky sistem përfshin shërbime të informimit dhe këshillimit për studentët, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për çështje të lidhura me programin e studimit dhe përparimin akademik. Njësitë e dedikuara, si tutori akademik dhe departamentet përkatëse, ndihmojnë studentët në monitorimin e progresit të tyre, u

me procesin mësimor dhe programin e studimit.	ofrojnë udhëzime për zhvillimin e programit mësimor dhe i asistojnë në zgjidhjen e çdo çështjeje që mund të lindë gjatë studimeve. Ky sistem kontribuon në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të procesit mësimor dhe garanton mbështetje të qëndrueshme për studentët në çdo hap të rrugëtimit të tyre akademik. <i>(Rregullore e sekretarisë)(Rregullore e tutoriatit akademik)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstatoi që në Universitetin Aldent është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike. Studenti informohet vazhdimisht dhe shërbehet sa herë ai e kërkon shërbimin. Në Universitetin Aldent Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët në mënyrë periodike që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Duke ndërmjetësuar interesimin dhe potencialet e të dyja palëve ajo realizon si kërkesat e tregut të punës ashtu edhe punësimin e studentëve të diplomuar. <i>(Statuti)</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gvj, gjatë vizitë së zhvilluar në Institucion, konstatoi se Zyra e Karrierës gjithashtu mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të Programit të Studimit. Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion studentëve nëpërmjet faqes zyrtare në internet. <i>(Statuti i UAL)</i> <i>(Rregullore e UAL)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka krijuar një sistem të strukturuar për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve, duke siguruar që ata të kenë mbështetje të vazhdueshme për çdo çështje që lidhet me procesin mësimor dhe programin e studimit; - Përfshirja e shërbimeve të dedikuara si tutori akademik dhe njësitë përkatëse garanton një monitorim të kujdesshëm të

	<i>progresit akademik të studentëve dhe ofron mundësi për zgjidhjen e çdo problemi që mund të ndodhi;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar RVB-së, Universiteti Aldent ka hartuar strategjine e zhvillimit të detajuar në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat janë të përshtatura për lëndët dhe modulet specifike të programit të studimit. Aktet rregullatore institucionale ofrojnë gjithashtu orientime të qarta për pedagogët mbi mënyrat e ndryshme të mësimdhënies, përfshirë metodat tradicionale dhe ato më moderne, të tilla si mësimi i integruar, përdorimi i teknologjisë dhe mësimi aktiv. Përdorimi i metodave inovative është i fokusuar në rritjen e angazhimit të studentëve dhe përmirësimin e rezultateve të mësimit, duke i mundësuar atyre të përvetësojnë njohuri në mënyrë më të efektshme dhe të zhvillojnë aftësi praktike dhe kritike. Kjo qasje e strukturuar kontribuon në përmirësimin e cilësisë akademike dhe ofron mundësi të reja për zhvillimin e studentëve në fushat e studimeve të tyre. <i>(Statuti i UAL)</i> <i>(Rregullore e UAL)</i> <i>(Strategjia e UAL)</i> <i>(Procedura e provimeve)</i>

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin periodik të mësimdhënies. Indikatorët e përdorur nga kjo njësi reflektohen në formularin e performancës së pedagogut. Kjo njësi përgatit raportin përfundimtar, në të cilin evidentohen problematikat eventuale dhe mundësitë për përmirësim. Objektivi kryesor i kësaj njësie është të identifikojë praktikatat efektive që kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të sigurojë një proces të vazhdueshëm për përmirësimin e standardeve akademike. Ky mekanizëm mbështet përpjekjet për zhvillimin dhe implementimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe siguron një pasqyrë të qartë mbi arritjet dhe sfidat që hasen gjatë këtij procesi. <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Raport NJSBC)</i> <i>(Raport i imazherisë)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në fund të semestrit dhe në mënyrë periodike, studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndëve. Pyetësi përmban një seri pyetjesh që synojnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të lëndës dhe performancës së pedagogut. Po ashtu, studentët janë vazhdimisht në kontakt me koordinatorin e programit për të paraqitur problematikat e tyre. Rezultatet e pyetësit analizohen dhe vlerësohen me qëllim përmirësimin e indikatorëve dhe treguesve të cilësisë akademike në institucion. Pas analizës, përgatitet raporti përfundimtar, i cili përfshin rekomandime dhe masat përkatëse për përmirësimin e procesit mësimor dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike. <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Pyetësi i studenteve)</i> <i>(Pyetësor i imazherisë)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar formatit të pyetësit, pyetësi për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga elementët kyç që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor për studentët përmban një analizë të detajuar me gjetjet dhe konstatimet lidhur me performancën e pedagogëve dhe përmbajtjen e lëndëve. Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Bashkëpunimit (NJSBC) është struktura përgjegjëse për analizimin e këtyre gjetjeve dhe i'a përcjell ato Senatit Akademik për diskutim dhe shqyrtim. Pas kësaj, NJSBC harton një plan aktivitetesh për të adresuar kërkesat dhe sugjerimet e

	studentëve, duke siguruar përmirësimin e cilësisë akademike dhe rritjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe të programeve të studimit. <i>(Rregullore e NjSBC)</i> <i>(Pyetsori i studenteve)</i> <i>(Pyetësor i imazherisë)</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Rezultatet e përftuara nga pyetësi dhe nga vlerësimi i performancës reflektohen në dosjen individuale të personelit akademik. Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira dhe inkurajon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe mundësi për zhvillim profesional. Gjithashtu, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare dhe inkurajon mobilitetin e stafit përmes projekteve të Erasmus+. Këto iniciativa synojnë rritjen e cilësisë akademike, zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale dhe shkëmbimin e përvojave me institucione të tjera arsimore ndërkombëtare. <i>(Pyetsori i studenteve)</i> <i>(Pyetësor i imazherisë)</i> <i>(Formular performance)</i> <i>(Marreveshjet e bashkëpunimit)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Institucioni ka një sistem të strukturuar dhe të mirëfilltë për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, i cili përfshin përdorimin e pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndëve, si dhe vlerësimin e performancës së personelit akademik; - Institucioni siguron mundësi të vazhdueshme trajnimi dhe zhvillimi profesional për stafin akademik dhe mbështet mobilitetin ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve dhe projekteve të Erasmus+;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ vëren se Universiteti Aldent ka krijuar dhe zbatuar politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale. Ky sistem siguron që cilësia e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të mbështetura akademike të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar. Përmes këtij sistemi, institucioni implementon dhe përmirëson procedurat e menaxhimit të cilësisë në çdo nivel, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve, proceset e studimit dhe ofrimin e shërbimeve të tjera për studentët. Ky mekanizëm i sigurisë së cilësisë është i projektuar për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të institucioneve akademike dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve të larta të arsimit. <i>(Rregullore e NjSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ vëren se Universiteti Aldent ka ngritur dhe mban në funksion një Sistemi të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, i cili siguron një strukturë të organizuar dhe efikase për menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Institucioni ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të qartë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, e cila përfshin angazhimin e studentëve, stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Kjo strategji është e orientuar drejt monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të proceseve të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe administratës, duke siguruar një përfshirje të gjerë të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin edukativ. Pjesëmarrja e ekspertëve të jashtëm dhe e studentëve në këtë proces garanton një perspektivë të plotë dhe objektive, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe eficiencës së arsimit të ofruar. <i>(Rregullore e NjSBC)</i> <i>(Pyetsori i studenteve)</i> <i>(Pyetësor i imazherisë)</i> <i>(Marreveshjet e bashkëpunimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe	GVJ vëren se Universiteti Aldent përdor një gamë të gjerë instrumentesh dhe treguesish për të siguruar cilësinë në arsimin

treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	e lartë. Institucioni ka implementuar procese të rregullta të vlerësimit të jashtëm, përfshirë akreditimin e programeve të studimit, si dhe vlerësime analitike e krahasuese që i mundësojnë atij të monitorojë dhe përmirësojë cilësinë e ofruar. Ky proces siguron që të gjitha programet akademike të përmbushin standardet e kërkuara dhe të jenë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Përveç vlerësimit të jashtëm, institucioni angazhon gjithashtu procese të brendshme që fokusohen në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të cilësisë, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe të studentëve. Kjo qasje e shumëfishtë promovon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe siguron që programet e studimit të jenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës dhe të shoqërisë. <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Raport NJSBC)</i> <i>(Raport i imazherisë)</i> <i>(Raport vjetor i UAL)</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vëren se Universiteti Aldent përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për të pasqyruar gjendjen aktuale, arritjet dhe dobësitë në këto fusha. Këta tregues janë të integruar në aktet rregullatore të institucionit dhe shërbejnë si një mjet efikas për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Nëpërmjet përdorimit të këtyre treguesve, institucioni është në gjendje të identifikojë fushat ku është arritur sukses dhe ato ku nevojiten përmirësime. Gjithashtu, institucioni përdor këta tregues cilësorë për të nxitur dhe promovuar arritjet më të mira, duke ofruar mundësi avancimi për studentët dhe stafin akademik që kanë kontribuar në arritjen e rezultateve të shkëlqyera. Kjo politikë stimulon një kulturë të vazhdueshme përmirësimi dhe motivon të gjithë aktorët e përfshirë në procesin akademik për të arritur standarde të larta në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. <i>(Statuti i UAL)</i> <i>(Rregullore e UAL)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Universiteti ka implementuar një sistem efikas për përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në

	<i>mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët ndihmojnë në pasqyrimin e gjendjes aktuale dhe identifikimin e arritjeve dhe dobësive;</i> <i>- Përmes treguesve cilësorë, institucioni është në gjendje të nxisë arritjet më të mira, duke motivuar studentët dhe stafin akademik për të arritur nivele të larta të performancës dhe duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm në programet e studimit;</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ vëren se Universiteti Aldent ka zhvilluar dhe përdor mekanizma të formalizuar dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të parë. Ky proces është i mbështetur në kriteret të qarta dhe të matshme, të cilat kontribuojnë në akreditimin e programeve dhe sigurojnë që ato të përmbushin standardet e kërkuara. Gjatë këtij shqyrtimi, identifikohen arritjet dhe dobësitë, ndërsa praktikatat dhe arritjet më të mira motivojnë zhvillimin e mëtejshëm të programit. Njëkohësisht, bëhet një planifikim për masat për përmirësim, duke siguruar që procesi të mbetet i qëndrueshëm dhe të rritet cilësia e programeve. Rezultatet e këtyre vlerësimeve janë të dokumentuara dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse për të mundësuar veprime të mëtejshme për përmirësimin dhe zhvillimin e programeve të studimit. <i>(Raport vjetor i UAL)</i> <i>(Raport i Imazherise)</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të	GVJ konstaton se, raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme dhe ato të arritura, duke reflektuar praktikatat më të

përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	mira dhe arritjet e personelit akademik dhe studentëve. Ato gjithashtu ofrojnë një analizë të dobësive të identifikuara dhe masat për adresimin e këtyre mangësive, duke përfshirë ristrukturimin e programeve, përmirësimin e standardeve akademike, dhe fuqizimin e infrastrukturës mësimore. Njësia ofruese e programit të studimit, së bashku me NJSBC, realizon ristrukturimin e programeve në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore, si dhe standardet dhe kriteret akademike. Pjesë e këtij procesi është edhe shqyrtimi i cilësisë dhe numrit të stafit akademik, përdorimi i teknologjisë bashkëkohore dhe përzgjedhja e teksteve universitare. UAL siguron një proces të rregullt dhe formal të shqyrtimit dhe miratimit të programeve, me mbikëqyrje të rregullt për të siguruar që ato përmbushin standardet e akreditimit dhe nevojat e studentëve. Në procesin e vetëvlerësimit, institucioni mbledh dhe analizon të dhëna cilësore dhe sasiore nga burime të ndryshme për të monitoruar përmbushjen e standardeve akademike dhe për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Në rastin e akreditimit, raporte të detajuara hartohen nga GVB dhe miratohen nga Senati Akademik për të siguruar që programet e studimit të qëndrojnë të përditësuara dhe të përputhura me kërkesat më të larta të cilësisë. <i>(Raport vjetor i UAL)</i> <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Raport NJSBC)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	GVJ konstatoi që Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korigjimit të provimeve, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese. Megjithatë, nuk janë vërejtur raste të vlerësimit paralel të provimeve apo detyrave të kursit, as vëzhgime në auditor. Po ashtu, testime të standardizuara nuk janë realizuar deri më tani. Në vend të këtyre praktikave, stafi akademik bazohet në pyetjet e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara, të cilat përdoren si udhëzues në hartimin e tezave të provimeve. Ky proces mund të përmirësohet më tej për të siguruar një vlerësim më të plotë dhe gjithëpërfshirës të cilësisë së programit të studimit. <i>(Rregullore e programit të studimit)</i> <i>(Procedura e provimeve)</i>



ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ konstaton se, Institucioni përdor disa instrumenta të tërthortë për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit, si pyetësorët për lëndën, pyetësorët për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësorët për kënaqësinë e studentëve me shërbimet, si dhe pyetësorët për alumni. Vlerësimi i pedagogëve realizohet në fund të çdo semestri, nga llogaria personale e studentëve, para fillimit të provimeve. Departamenti përgatit raporte mbi rezultatet e anketave, të cilat përpunohen dhe përdoren për vlerësimin dhe përmirësimin e mbarëvajtjes së programit. GVJ konstaton, mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet e realizuara, se këto instrumenta përdoren periodikisht dhe kanë kontribuar në përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu, UAL përdor metodologji të qarta për vlerësimin e performancës akademike, duke përfshirë treguesit e performancës dhe pyetësorët e studentëve. Strukturat e SBC, Dekani i Fakultetit dhe përfaqësuesi i NJSBC në programin e studimit mbikqyrin zbatimin e programit mësimor dhe sigurojnë se raportet e rezultateve të pyetësorëve kalojnë nëpërmjet Rektoratit dhe Senatit Akademik për të marrë masat dhe vendimet e duhura për përmirësimin e cilësisë dhe performancës. Cdo fund vit akademik, NJSBC publikon Raportin Vjetor, në të cilin përfshihet plani i masave për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. <i>(Raport vjetor i UAL)</i> <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Raport NJSBC)</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - institucioni ka implementuar një sistem të strukturuar për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, duke përdorur metoda dhe instrumente të tërthorta si sondazhe dhe intervista me studentë, alumni dhe punëdhënësit; - Raportet e vlerësimit dhe masat e marrë për adresimin e mangësive janë të shpërndara dhe miratohen përmes strukturave të vendimmarrjes të institucionit;

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në përbërje të NJSBC ka aktorë që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi, nga një anëtar për cdo fakultet, një ekspert të jashtëm si dhe një përfaqësues studentësh, me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Tabelat RVB, tabela 20)(Rregullore e NJSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të definuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Këto aktet rregullatore specifikojnë në mënyrë të detajuar mënyrën e krijimit të organeve përkatëse, funksionet kryesore të tyre, proceset e vendimmarrjes dhe ndërveprimin me njësitë e tjera të institucionit. GVJ vëren se detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi sigurojnë ushtrimin e duhur dhe me përgjegjësi të proceseve të sigurimit të cilësisë. <i>(Statuti i UAL)(Rregullore e NJSBC)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe	Sipas dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit përfshihen në mënyrë aktive njësitë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin, si dhe të gjithë anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ. Po ashtu, studenti dhe përfaqësuesit e tij janë të përfshirë në vlerësimin e programit përmes pyetësorëve dhe diskutimeve të organizuara. Ky proces garanton një përfshirje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, duke siguruar një vlerësim

studentëve e programit të studimit.	të plotë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. <i>(Rregullore e NjSBC)</i>			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se institucioni ka procedura dhe mekanizma të qarta që sigurojnë përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke respektuar integritetin akademik. Këto procese janë të strukturuar për të shmangur çdo lloj diskriminimi ose pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Dokumentacioni dhe praktikat e vlerësimit janë të qarta dhe transparente, duke garantuar një trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë përfshirësit në proces. <i>(Rregullore e programit të studimit)(Rregullore e NjSBC)</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësinë të takojë me aktorë kyç të jetës akademike, përfshirë Dekanin e Fakultetit, Përgjegjës të Departamentit, përfaqësues të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me grupin e vetëvlerësimit, përfaqësues të NjSBC dhe Zyrës së Karrierës. Takimet konfirmuan një organizim të mirë të punës së përditshme, angazhim të plotë në procesin e akreditimit dhe një motivim të lartë për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni ka arritur të përfshijë bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm, të cilët janë të pranishëm në proceset e vlerësimit dhe kontribuojnë me ekspertizën e tyre, duke siguruar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë. Sipas dokumentacionit dhe Tabelave RVB, një anëtar/ekspert i jashtëm është pjesë e NjSBC, duke garantuar integritetin e palëve të jashtme në vlerësimin e programit të studimit dhe proceset e sigurimit të cilësisë. <i>(Tabelat Permbledhese)(Vizita në Institucion)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - institucioni ka arritur të krijojë një proces të strukturuar dhe të efektshëm për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në proceset e vlerësimit; - Pjesëmarrja aktive e stafit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm garanton një proces të drejtpërdrejtë dhe të integruar të vlerësimit, duke respektuar gjithashtu integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi;			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë është angazhuar në mënyrë aktive për trajtimin dhe zgjidhjen e sfidave që lindin gjatë mësimdhënies dhe auditimeve të ndryshme në strukturë. Institucioni respekton plotësisht lirinë akademike dhe etikën, si dhe garanton përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë janë miratuar formalisht, të dokumentuara dhe rishikuar rregullisht për t'iu përgjigjur ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm. <i>(Statuti i UAL)(Rregullore e NJSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informuese për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogëve dhe ndikimin e këtyre rezultateve në përmirësimin e programit të studimit. Institucioni siguron transparencë në publikimin e këtyre rezultateve, duke respektuar plotësisht lirinë akademike, etikën dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Pyetësor i studentëve)</i> <i>(Pyetësor i imazherisë)</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni harton dhe implementon një plan masash për të adresuar mangësitë dhe dobësitë e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit. Ky plan masash është i bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke përfshirë ndërhyrje të nevojshme në aspektet e mësimdhënies, kurrikulës dhe mbështetjes për studentët. Plani masash siguron gjithashtu monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve të ndërmarra. <i>(Rregullore e NJSBC)</i> <i>(Raport NJSBC)</i> <i>(Raport i imazherisë)</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron	Institucioni siguron që monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë të kenë ndikim të matshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të

efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	programit të studimit. Kjo arrihet përmes analizës të rezultateve të vlerësimeve dhe implementimit të masave korrigjuese, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimit të standardeve akademike. Institucioni ndjek me rigoroitet efektivitetin e këtyre veprimtarive, duke siguruar që përmirësimet të jenë të qëndrueshme dhe të dokumentuara për të garantuar progresin e vazhdueshëm. <i>(Raport NJSBC)</i> <i>(Raport i imazherisë)</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në përgjithësi, rezultatet e këtyre aktiviteteve kanë evidentuar disa problematika, por ato kanë qenë të natyrës jo madhore dhe nuk kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në procesin akademik. Kjo tregon angazhimin e institucionit për të përmirësuar cilësinë dhe për të siguruar një mjedis të favorshëm mësimor. <i>(Raport NJSBC)</i> <i>(Raport vjetor i UAL)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - institucioni ka krijuar mekanizma efektivë për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, duke angazhuar personelin dhe studentët në veprimtari periodike informimi dhe ndërgjegjësimi; - Institucioni ka treguar angazhim të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës akademike;			
Shkalla e përmirësimit të standardit	Nuk përmirësohet	Përmirësohet pjesërisht	Përmirësohet kryesisht	Përmirësohet plotësisht
				X

Shkalla e përmirësimit të standardeve të fushës VI	Nuk përmirësohet	Përmirësohet pjesërisht	Përmirësohet kryesisht	Përmirësohet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në: “Teknik Imazherie dhe Radioterapi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ofrohet nga një Universitet, i cili ka imazh shumë të mirë lidhur me cilësinë e produkteve të tij studentore;
2. Programi i studimit ofrohet me veçorinë e zhvillimit të mësimin në një Universitet me orientim tërësisht në fushën e mjekësisë;
3. Personeli akademik i këtij programi, si pjesë përbërse edhe e personelit akademik të Universitetit, ndjehet i vlerësuar dhe i përkushtuar në angazhimin e tij për të arritur rezultate sa më të mira dhe për të merituar vlerësimin e studentëve;
4. Personeli akademik është i specializuar në drejtim të imazherisë mjekësore si dhe radioterapisë;
5. Ka një angazhim të konsiderueshëm edhe të personelit akademik dhe ndihmës akademik me përgatitje si Teknik Imazherie;
6. Caktimi i një këshilltari akademik për çdo student edhe në këtë program, rrit sigurinë e studentëve në përballimin me sukses të gjithë problematikës gjatë kohës së studimeve;
7. Infrastrukturë dhe logjistikë bashkëkohore në funksion të programit të studimit;
8. Strukturë eficiente në organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies vecanërisht asaj online gjatë periudhës së pandemisë dhe jo vetëm;
9. Marrëveshje dhe bashkepunime në funksion të programit të studimit, vecanërisht me institucione shëndetësore dhe klinika private;

b. Pika të dobta:

1. Nevoja për përmirësim të literaturës imazherike si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të programit të studimit; në Bibliotekën e Universitetit me tituj të tjerë kryesisht në radioterapi, të paktën të atyre që ekzistojnë aktualisht në mësimdhënien në Shqipëri; (*Standarti IV.3 kriteri 4*)
2. Probleme minimale në ndërtimin e programit të studimit në lidhje me selektimin e disa lëndëve në rubrika specifike (A, B, C, D, E) për dhënien e rëndësisë së duhur përgatitjes së studentëve; (*Standarti II.3 Kriteri 2*)

Rekomandime:

1. Të pasurohet biblioteka e Universitetit me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me këtë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të programit të studimit;
2. Të përmirësohet dhe standartizohet në vijimësi kurrikula e programit të studimit me synimin që të lehtësohet më tej mobiliteti i studentëve drejt cikleve të studimit master, si dhe të bëhet më praktik e më i dobishëm angazhimi i të diplomuarve të këtij programi në kabinetet shëndetësore. Në këtë kuadër rekomandohet kalimi i lëndës së mamografisë nga lëndë me zgjedhje në lëndë të formimit karakterizues;

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program "Imaging and Radiotherapy Technician."

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is offered by a University, which has a very good image regarding the quality of its student products;
2. The study program is offered with the peculiarity of developing learning in a University with an orientation entirely in the field of medicine;
3. The academic staff of this program, as an integral part of the academic staff of the University, feels valued and dedicated in its commitment to achieving the best possible results and to deserving the appreciation of students;
4. The academic staff is specialized in the field of medical imaging and radiotherapy;
5. There is a considerable commitment of the academic staff and academic assistants with training as Imaging Technicians;
6. The assignment of an academic advisor for each student in this program also increases the students' confidence in successfully facing all the problems during their studies;
7. Modern infrastructure and logistics in function of the study program;
8. Efficient structure in the organization and development of teaching, especially online teaching during the pandemic period and beyond;
9. Agreements and collaborations in function of the study program, especially with health institutions and private clinics;

b. Weaknesses:

1. The need to improve the imaging literature at the University Library and update its existing fund in support of the study program with other titles mainly in radiotherapy, at least those that currently exist in Albania; (*Standard IV.3 criteria 4*)
2. Minimal problems in building the study program regarding the selection of some subjects in specific sections (A, B, C, D, E) to give due importance to the preparation of students; (*Standard II.3 criteria 2*)

Recommendations:

1. To enrich the University library with Albanian titles or texts related to this study program, as well as to update its existing fund in support of the study program;
2. To continuously improve and standardize the curriculum of study program with the aim of further facilitating the mobility of students towards master's study level, as well as to make the engagement of graduates of this study program in health offices more practical and useful. In this context, it is recommended to change the mammography subject from an elective to a characterizing training subject;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X